

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6072  
E shtunë, 25 korrik 2020  
çmimi 0.40 €

Covid-19 në Kosovë:  
Gjashtë të vdekur dhe  
213 të infektuar | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## OPINION

NË KOSOVË LINDI RINGRITJA  
SHQIPTARE (16) F. 11

Shkruan:  
Kudusi LAMA



## AKTUALE



KE: VENDET E BE-SË, URGJENT  
TA ZGJEROJNË RRJETIN E  
FURNIZUESVE TË 5G-s F. 2

MPB-ja: REGJISTRIMI  
I AUTOMJETEVE DUHET TË  
BËHET DERI MË 17 GUSHT F. 6

ZEMAJ THOTË SE QYTETARËVE  
DO T'U OFROHEN SHËRBIME MË  
TË MIRA SHËNDETËSORE F. 3



## EKONOMI

OEA ORGANIZON TRAJNIM PËR  
SHITJE ONLINE F. 9

'QYTETARË TË  
PAPËRGJEGJSHËM PO KYÇIN  
KANALIZIMET NË KANALET  
KABLOVIKE TË KEDS-it' F. 8

## SPORT

SERMAXHAJ: JAVA E FUNDIT NË  
SUPERLIGË DO TË JETË SHUMË  
INTERESANTE F. 16

KRYEMINISTRI I VENDIT, AVDULLAH HOTI, KA RAPORTUAR TË PREMTEN PARA  
DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS PËR RIFILLIMIN E DIALOGUT TË BRUKSELIT

## OPOZITA KRITIKON QASJEN E KRYEMINISTRIT PËR DIALOGUN



Në raportimin e parë në Kuvendin e Kosovës, kryeministri Avdullah Hoti ka marrë kritika të ashpra nga opozita dhe nga partnerët e koalicionit qeverisës për takimin e parë që ka zhvilluar me presidentin serb Aleksandër Vuçiç në Bruksel. Deputetët e opozitës kanë thënë se kryeministri Hoti në takimin e 16 korrikut ka shkuar pa platformë, pa ekip dhe pa agjendë të caktuar. Shefi i ekzekutivit ka mohuar kritikën e subjekteve politike opozitare duke thënë se dialogu me Serbinë do të jetë vetëm për njohje reciproke e jo për çështje teknike | FAQE 4-5

## THAÇI DHE HOTI, TAKIM KOORDINUES PËR DIALOGUN DHE LUFTËN KUNDËR PANDEMISË



Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Avdullah Hoti janë takuar të premtën dhe janë koordinuar rreth luftës kundër

panemisë Covid-19, për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë si dhe për çështje të tjera që ndërlihen me zhvillimin ekonomik,

reformat dhe pakon ekonomike. Thaçi dhe Hoti kanë theksuar se procesi i dialogut me Serbinë nuk duhet të zbrësë në nivel teknik | FAQE 2

## Dështojnë propozim-rezolutat për Telekomin dhe pensionistët | FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## KE: Vendet e BE-së urgjent ta zgjerojnë rrjetin e furnizuesve të 5G-s

BRUKSEL, 24 KORRIK - Vendet e BE-së duhet të ndërmarrin veprime urgjente për ta zgjeruar listën e furnizuesve të tyre me teknologjinë 5G, tha Komisioni Evropian të premten. Shtetet e Bashkuara po i nxisin vendet evropiane ta ndjekin shembullin e Britanisë së Madhe e cila vendosi të largojë nga rrjeti i saj 5G, kompaninë kineze "Huawei".

Në nëntor të vitit të kaluar BE-ja ra dakord të mbajë një qëndrim të ashpër mbi kushtet e furnizuesve të



rrjetit 5G për t'i zvogëluar rreziqet e sigurisë në inter-

net. Strategjia përfshinte uljen e

varësisë së vendeve dhe operatorëve të telekomit nga një furnizues. Prodhuesi lider i pajisjeve të telekomit në botë, "Huawei", garon në treg me "Nokian" e Finlandës dhe "Ericssonin" e Suedisë. "Urgjentisht duhet të zvogëlohet varësia nga furnizuesit me rrezik të lartë", ka thënë ekzekutivi i BE-së.

Komisioni, gjithashtu, u bëri thirrje 13 vendeve të BE-së që ta miratojnë mekanizmin e kontrollit të investimeve të huaja direkte, një mjet i cili

lejon qeveritë e BE-së të ndërhyjnë në rastet e investimeve të huaja direkte në asetet strategjike, veçanërisht nëse përfshihen ndërmarrje të kontrolluara nga shteti ose të financuara nga shteti.

Shtetet e Bashkuara thonë se kompania "Huawei" e Kinës është e lidhur me qeverinë kineze. Rrjeti 5G paraqet gjeneratën e fundit të lidhjes së telefonave të mençur me internet dhe ofron shpejtësi të shkarkimit shumëfish më të shpejtë sesa ekziston aktualisht.

## Takohen Meta e Basha, diskutojnë për kodin zgjedhor

TIRANË, 24 KORRIK - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka pritur në takim kryetarin e Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha, të cilin e ka siguruar se do t'i dekretojë ndryshimet e Kodit Zgjedhor. Më tutje, Meta ka thënë se e ka inkurajuar Bashën që të bashkëpunojë me të gjithë partnerët për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkim

Evropian (BE). "E sigurova z. Basha se do t'i dekretojë menjëherë ndryshimet e Kodit Zgjedhor në respekt të marrëveshjes konsensuale të 5 qershorit. E falënderova për kontributin konstruktiv për arritjen e marrëveshjes së 5 qershorit dhe i kërkova ta vazhdojnë punën në Këshillin Politik në frymën e konsensusit duke mos rënë pre e asnjë

provokimi. Inkurajova vijimin e bashkëpunimit të ngushtë me të gjithë partnerët e investuar për çeljen sa më parë të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian dhe që kanë mbështetur Këshillin Politik në frymën e konsensusit dhe gjithëpërfshirjes", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".



## Interpoli: Janë arrestuar disa mafiozë të fuqishëm në Shqipëri, Kosta-Rikë dhe Argjentinë



LYON, 24 KORRIK - Gjashtë anëtarë të dyshuar të grupit të fuqishëm mafioz italian "Ndrangheta" janë arrestuar në Shqipëri, Argjentinë dhe Kosta-Rikë për dyshime të trafikimit të drogës dhe armëve, ka njoftuar të premten Agjencia Ndërkombëtare e Policisë (Interpol). Të dyshuarit mendohet se kanë lidhje me klanin 'Ndrangheta Bellocco' nga Rosarno në jug të Italisë, i cili është i përfshirë në importimin e kokainës në Amerikën e Jugut me anije nga Argjentina dhe

Kosta-Rikë, thuhet në një deklaratë.

Në një operacion të përbashkët të mbikëqyrtur nga Interpoli dhe policia italiane, tre anëtarë të bandës u arrestuan në Buenos-Aires, një në kryeqytetin shqiptar Tiranë dhe një tjetër në Kosta-Rikë gjatë kësaj jave. Një i dyshuar i gjashtë, i cili kishte shmangur arrestimin vitin e kaluar, gjatë një operacioni policor ndërkombëtar anti-mafia, u arrestua në Shqipëri në muajin

maj.

Në total, policia sekuestroi 400 kilogramë kokainë, 30 kilogramë hashash, 15 kilogramë marijuanë, një pushkë automatike, tri pistoleta gjysmautomatike, një revole me shurdhues dhe municion të kalibrave të ndryshëm, thuhet në deklaratën e Interpolit.

Ndrangheta, me qendër në rajonin e Kalabrisë në Itali, është bërë grupi mafioz më i fuqishëm i vendit që vepron në të gjithë botën, raporton AFP.

## Johnsoni: Kriza e koronavirusit përfundon nga mesi i 2021-s

LONDËR, 24 KORRIK - Kryeministri britanik Boris Johnson ka thënë se vendi do ta kalojë krizën e koronavirusit nga mesi i vitit 2021, por frika e tij ishte se do të kishte një goditje të dytë të pandemisë. Ai ka pohuar se të gjithë duhet ta marrin vaksinën kundër gripit sezon-

al për ta parandaluar mbingarkimin e shërbimeve shëndetësore gjatë dimrit. Mbretëria e Bashkuar ka fuqizuar masat kundër përhapjes së koronavirusit duke e bërë të detyrueshme mbajtjen e maskës brenda dyqaneve, qendrave tregtare të mbyllura, në banka dhe

institucione të tjera. Policia mund t'i gjobisë deri në 100 funta ata që nuk respektojnë masën. Sipas Universitetit "Johns Hopkins", në Mbretërinë e Bashkuar janë regjistruar gjithsej 298 731 raste me koronavirus, prej të cilëve 45 639 kanë vdekur.



# Covid-19 në Kosovë: Gjashtë të vdekur dhe 213 të infektuar

Republika e Kosovës vazhdon ta ketë numrin e lartë të rasteve të reja me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se vetëm në 24 orët e fundit në vendin tonë janë infektuar nga koronavirusi 213 persona. Po ashtu, ky institut ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore kanë vdekur gjashtë persona me Covid-19 si dhe janë shëruar 109 të tjerë

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 24 KORRIK (ER)** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit kanë vdekur gjashtë persona nga Covid-19 dhe janë infektuar 213 të tjerë. Po ashtu, ky institut ka njoftuar se nga Covid-19 janë shëruar edhe 109 persona duke e çuar në 3 614 numrin e përgjithshëm të të shëruarave. "Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 494 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 213 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 6 680 raste, nga 33 289 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me

gjithsej 164 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 109 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 3614 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2902", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se Prishtina vazhdon të prijë me numrin e rasteve me Covid-19. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 80 raste, komuna Prizren 17 raste, komuna Ferizaj 15 raste, komuna Gjiilan 14 raste, komuna Podujevë 12 raste, komuna Drenas 11 raste, komuna Fushë Kosovë 9 raste, komuna Mitrovicë 7 raste, komuna Suharekë 7 raste, komuna Lipjan 6 raste, komuna Pejë 6 raste, komuna Viti 6 raste, komuna Vushtrri 5 raste, komuna Skenderaj 4 raste, komuna Deçan 3 raste, komuna

Malishevë 3 raste, kurse nga 2 raste komunat: Dragash, Kamenicë, Klinë dhe nga 1 rast Obiliq dhe Shtime", ka njoftuar ky institut. Më tutje, IKShPK-ja ka ripërsëritur thirrjen për respektimin e rekomandimeve të institucioneve shëndetësore për mbrojtje nga koronavirusi. "Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën

fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura. Ne po shkojmë drejt një normaliteti të ri. Ky normalitet i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të mirë, për ta mbajtur higjienën, për ta mbajtur distancën, për ta mbajtur maskën, për të mos përhapur

piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmve, të familjes, të fëmijëve, të farefisit, të komunitetit, pastaj të të gjithë qytetarëve", ka njoftuar IKShPK-ja. Sipas IKShPK-së, çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve.

## Zemaj thotë se qytetarëve do t'u ofrohen shërbime më të mira shëndetësore

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 24 KORRIK** - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, gjatë vizitës në Klinikën e Kirurgjisë Torakale në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ka thënë se bashkë me profesionistët shëndetësorë po angazhohet për kthimin e të gjitha shërbimeve shëndetësore për pacientët edhe në kohën e pandemisë së Covid-19. "Personeli ynë është përballur me vështirësi dhe me infeksion. Është dashur ta shkurtojmë stafin në nivele të ndryshme, por mendojmë tani t'i shfrytëzojmë të gjitha kapacitetet. Do të analizojmë situatën dhe, krahas ofrimit të shërbimeve për pacientët Covid-19, do të ofrojmë edhe shërbime të tjera", ka thënë ai. Zemaj ka thënë se kjo klinikë ka specifikat e veta, ndërsa ai dhe Ministria e Shëndetësisë është në shërbim të fuqizimit të klinikave, stafit dhe profesionistëve shëndetësorë, me qëllim që qytetarëve t'u ofrohen shërbimet më të mira



shëndetësore. Valbon Krasniqi, ushtrues detyre i drejtorit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, ka thënë se, edhe pse qytetarët janë të njoftuar se po përballemi me pandeminë Covid-19, si ShSKUK kanë obligim të merren me trajtimin edhe të sëmundjeve të tjera. "Pacientët që kanë nevojë për shërbime kirurgjike akute po i

marrin këto shërbime meqë po funksionojnë, pa marrë parasysh ashpërsinë e pandemisë Covid-19. Shërbime emergjente do të vazhdojnë të marrin të gjithë ata që kanë nevojë për shërbime emergjente", ka thënë ai. Ndërsa Saudin Maliqi, drejtor i Klinikës së Kirurgjisë Torakale në QKUK, ka dhënë sqarime në lidhje me shërbimet që kryhen

në këtë klinikë. "Jemi në gatishmëri të plotë me një staf të përgatitur e të ngritur me një trajnim të bërë jashtë vendit. Jemi këtu që t'u përgjigjemi nevoja kirurgjike për pacientë. Kemi bërë një plan operativ që, përkundër gjendjes Covid-19, situatës së ngarkuar, t'i marrim masat që t'i bëjmë programet operatore në mënyrë që asnjë nga të sëmurët të mos mbetet

keq në ditët në vazhdim", ka thënë ai. Klinika e Kirurgjisë Torakale në QKUK është e vetmja në Kosovë që ofron shërbime shëndetësore të niveli tretësor, duke përfshirë trajtimin e kancerit të gjirit, traumës së kraharorit dhe të gjitha sëmundjeve malinje të kraharorit, pa përjashtuar edhe sëmundjet e tjera të kraharorit.

Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka raportuar të premtën para deputetëve të Kuvendit të Kosovës për rifillimin e dialogut

# Opozita kritikon qasjen e



Në raportimin e parë në Kuvendin e Kosovës, kryeministri Avdullah Hoti ka marrë kritika të ashpra nga opozita dhe nga partnerët e koalicionit qeverisës për takimin e parë që ka zhvilluar me presidentin serb Aleksandër Vuçiq në Bruksel. Deputetët e opozitës kanë thënë se kryeministri Hoti në takimin e 16 korrikut ka shkuar pa platformë, pa ekip dhe pa agjendë të caktuar. Shefi i ekzekutivit ka mohuar kritikën e subjekteve politike opozitare duke thënë se dialogu me Serbinë do të jetë vetëm për njohje reciproke e jo për çështje teknike

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 24 KORRIK - Opozita dhe një pjesë e koalicionit qeverisës e kanë kritikuar qasjen e kryeministrit Avdullah Hoti për rifillimin e procesit të dialogut me Serbinë. Në raportimin e tij para deputetëve për takimin me presidentin serb Aleksandër Vuçiq, më 16 korrik në Bruksel, kryeministri ka përsëritur qëndrimin e tij se dialogu me Serbinë është për njohje reciproke dhe jo dialog teknik. Ai ka treguar se në këtë takim është diskutuar për zbardhjen e çështjes së të

pagjeturve dhe për temat ekonomike. "Tema e parë, personat e pagjetur për Qeverinë e Kosovës, është obligim shtetëror, moral ndaj familjeve të tyre. Andaj është trajtuar me parime dhe kërkesa të qarta që janë: në përputhje të plotë me Ligjin humanitar ndërkombëtar, të zgjidhet çështja e personave të zhdukur, përfshirë zbulimin e informacionit dhe ofrimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe teknike për zgjidhjen e kësaj çështjeje. E dyta, sjellja e drejtësisë në vend dhe e treta, kujdesi i nevojshëm për familjet e viktimave sipas

standardeve ndërkombëtare", ka thënë Hoti, duke shtuar se ka kërkuar që të kenë informacione edhe nga arkivat e ish-Jugosllavisë. Për çështjet ekonomike, Hoti ka deklaruar se do të kërkohet kompensim për dëmet e luftës dhe kompensim për dëmet e pronave private. "Dua ta konfirmoj edhe njëherë që për Qeverinë e Kosovës dhe për mua si kryeministër nuk ka dhe nuk do të ketë dialog teknik. Të gjitha takimet në ditët në vijim do të jenë vetëm për draftimin e marrëveshjes finale për njohje reciproke dhe normalizim të marrëdhënieve në mes të dy

vendeve", ka deklaruar kryeministri Hoti, duke shtuar se përgjegjësinë kryesore në këtë proces do ta ketë ai. "Unë e kam përgjegjësinë në këtë proces. Unë do t'ju mbaj të informuar gjithë kohën për zhvillimet në këtë proces dhe do të jem llogaridhënës karshi jush. Por, unë nuk do të rri duarkryq, dhe as nuk do të qahem para jush duke u ankuar për teori konspirative me harta e thika, apo me komplete për ndarje territoriale. Unë do t'i ushtroj autorizimet e mia kushtetuese, pa interferim nga askush", ka thënë Hoti.

Në raportimin e tij, kryeministri ka folur edhe për caktimin e koordinatorit shtetëror për dialog. "Zoti Hyseni ka një përvojë të madhe në diplomaci, duke qenë afër presidentit Rugova, duke shërbyer si shef i diplomacisë së Kosovës dhe personi kryesor që e ka përfaqësuar Kosovën në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, kur u vulos Deklarata e Pavarësisë. Unë i besoj atij dhe ai më përgjigjet mua. Ai më

përfaqëson mua në procesin e dialogut dhe punon sipas udhëzimeve të mia", është shprehur ai.

Edhe para deputetëve, kryeministri Hoti ka përsëritur tri parimet e qeverisë në dialog. Në këtë raportim, kryeministri është përkrahur vetëm nga partia e tij, LDK-ja.

Qasja e Hotit në takimin e parë me Vuçiqin është kritikuar nga partneri i madh i koalicionit, AAK-ja. Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Daut Haradinaj, ka thënë se partia e tij mbështet dialogun, por jo këtë dialog. Ai ka vlerësuar se dialogu në Bruksel asnjëherë nuk ka prodhuar asgjë të mirë për Kosovën, pa praninë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Kërkesa jonë si parti politike, si partner i koalicionit, është e qartë: Nuk bën të rrëshqitet në dialogun teknik sepse dialogu teknik e favorizon Serbinë që t'i hapë kapitujt e integritimit. Në rast se një marrëveshje arrihet pa praninë e ShBA-së, ajo zor se është e zbatueshme", ka deklaruar Haradinaj.

: të Brukselit

# kryeministrit për dialogun



Ai ka vlerësuar se nuk ka keqkuptime në bashkëqeverisje, por që është kërkesë eksplicite që ShBA-ja të jetë e pranishme në tavolinën e bisedimeve. “Nuk kemi çfarë kërkojmë në Bruksel pa na u hequr vizat. Duhet të jetë kusht në tavolinë dhe t’u bëhet e qartë dhe me dije”, ka deklaruar Haradinaj.

## LV-ja e PDK-ja: Hoti e turpëroi Kosovën në Bruksel

Kritika më të ashpra se AAK-ja kanë pasur dy partitë opozitare, Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës. Shefi i grupit parlamentar i LV-së, Rexhep Selimi, ka thënë se kryeministri Hoti në takimin e 16 korrikut në Bruksel ka shkuar pa platformë, pa ekip dhe pa agjendë. “Ju atje nuk demonstruat shtetësi, as legjitimitet, as dinjitet. Shkuat duke hequr dorë nga reciprociteti, pra nga shtetësia, pra jo si dy shtete. U paraqitët pa dinjitet, duke demonstruar

inferioritetin tuaj ndaj Vuçiqit e, po ashtu, edhe pa legjitimitet sepse nuk e morët përkrahjen e spektrit politik në Kosovë”, ka thënë Selimi.

Gjithashtu, ai ka kritikuar kryeministrin që iu përgjigj në gjuhën serbe Vuçiqit, kur ky i fundit e kishte pyetur nëse e kuptonte gjuhën serbe. “Emërimi i koordinatorit. A po e bëni të njëjtën gjë si Ramush Haradinaj i cili ia delegoi dialogun presidentit. Z. Hoti, më fal që po ta them, por doja ta dija si përgjigje: A duhet që para se të shkosh në bisedime me Vuçiqin që ta mësosh serbishten? Ti nuk je i serbishtes, për dallim nga shefi yt i partisë. Ti është dashur që t’i përgjigjeshe shqip. Na turpërove kryeministër”, ka vlerësuar ai. Selimi ka deklaruar se Hoti për këtë proces e ka përkrahjen vetëm të presidentit Hashim Thaçi, duke shtuar se vetëm presidenti i vendit e ka përshëndetur emërimin e Hysenit për koordinator shtetëror për dialog.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë se qeveria nuk ka platformë e as strategji për këtë proces. “Pa afat, pa cak, pa unitet. Të ndiqet një karvan i dialogut, pa e ditur cakun, afatin, kohën. Prandaj, po e shohim problem qasjen e qeverisë në dialog. Ne nuk jemi kundër dialogut dhe nuk do të jemi asnjëherë kundër dialogut. Nuk ka platformë. Çfarë po thotë kryeministri është pozicionimi legal i Kosovës. Kushtetuta është pozicionimi legal i Kosovës. Platforma është platformë për të arritur marrëveshje”, ka thënë Hoxhaj, duke treguar çka është strategjia. “Nuk ka strategji, e strategjia është një dokument për temat që dëshironi t’i ngrehni”, ka thënë Hoxhaj.

Ai e ka kritikuar Hotin se pse në takimin e 16 korrikut ka lejuar që në Bruksel të ngrehet çështja e të zhvendosurve. “Te tema e ekonomisë, veç na tregoni ku fillon dhe ku mbaron ekonomia dhe tregtia e Kosovës me Serbinë”, është shprehur Hoxhaj. Pas 20 muajsh ndërprerje, më 16 korrik ka rinisur dialogu politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Pas këtij takimi, delegacionet e ekspertëve të të dyja vendeve, më 23 korrik janë takuar në Bruksel. Në këtë takim Kosova është përfaqësuar nga koordinatori shtetëror për dialog, Skender Hyseni dhe palën serbe e ka përfaqësuar shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq.

## Pritet zhbllokimi i llogarive bankare të Postës së Kosovës

PRISHTINË, 24 KORRIK - Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës paralajmërojnë zhbllokimin e llogarive bankare të Postës së Kosovës. Bllokimi i llogarive të Postës u bë të enjten nga Administrata Tatimore për shkak të një borxhi ndaj kësaj administrate në vlerë rreth 1.3 milion eurosh, e cila është grumbulluar gjatë periudhës 2019-2020.

Zyrtarë të Postës pohojnë se kjo kompani po përballlet me kushte të rënda financiare për shkak të borxhit që i kanë kësaj kompanie Qeveria dhe Telekomit të Kosovës.

Vlera e borxhit që qeveria i ka Postës borxh që është grumbulluar ndër vite llogaritet të jetë rreth pesë milionë euro thotë për “Radion Evropa e Lirë”, Besnik Krasniqi, udhëheqës i Njësisë për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit. Borxhi i qeverisë ndaj Postës është krijuar pasi Posta ofron shërbime universale postare në gjithë territorin e Kosovës, kurse në bazë të ligjit, qeveria është e obliguar t’i mbulojë shpenzimet.

Krasniqi tregon se pas një takimi me udhëheqës të Postës është premtuar se Qeveria e Kosovës do ta shlyejë borxhin e grumbulluar. “Nga dita e hënë, besoj se Posta mund të fillojë të funksionojë normalisht, pasi qeveria do të fillojë ta shpaguejë borxhin e grumbulluar nga qeveritë e kaluara”, ka thënë

Krasniqi.

Përveç qeverisë, edhe Telekomit të Kosovës i ka borxh Postës rreth 1.4 milion euro.

Një pjesë e borxhit të Telekomit ndaj Postës është krijuar për shkak të mospagesës së qirave për disa objekte të Postës që i shfrytëzon Telekomit.

Udhëheqës të Postës së Kosovës thanë se janë duke përgatitur marrëveshje për programim të borxhit me Administratën Tatimore të Kosovës.

Kryeshefi ekzekutiv në Postën e Kosovës, Salih Morina, në një bisedë për “Radion Evropa e Lirë” tregon se zyrtarë të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit kanë premtuar se do fillojnë ta paguajnë borxhin ndaj Postës, mjete këto që do të transferohen në llogarinë e ATK-së. “Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit (Blerim Kuçi) ka premtuar se borxhi do të rimbursohet. Tashmë mbetet të përgatitet marrëveshja që kështu e ATK-së t’i rimburojë Qeveria e Kosovës”, thekson Krasniqi duke mos paraqitur ndonjë periudhë kohore për programim të borxhit në baza mujore.

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) mund t’i zhbllokojë llogaritë bankare të Postës së Kosovës nëse kjo e fundit, në bazë të një kërkesë, dëshmon se ka vështirësi financiare dhe kërkon programim të borxhit, thotë për “Radion Evropa e Lirë”, drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj. “Ende nuk kemi

një marrëveshje të tillë. Ka mbetur që kompania të parashtrijë kërkesë në ATK, duke sjell faktet dhe argumentet për programim të borxhit. Dhe pastaj zyrtarët tatimorë, bazuar në faktet që sjellin, i mundësojnë programim të borxheve ose, nëse nuk ka fakte të mjaftueshme, do t’i kërkohej që ta paguajë tërësisht borxhin”, ka thënë Murtezaj.

Ndryshe, Posta e Kosovës ka operuar në sistemin e Postës dhe Telekomit të Kosovës, mirëpo në vitin 2012, me një vendim të qeverisë, ajo është ndarë nga Telekomit dhe është themelua si Ndërmarrje Publike Qendrore.

Posta e Kosovës dy herë i është nënshtruar procesit të privatizimit, por dy herë radhazi Qeveria e Kosovës ka dështuar ta përmbyllë këtë proces me sukses.

Me bllokim të llogarive bankare është duke u përballur edhe Telekomit të Kosovës. Por, bllokimi i llogarive të kësaj agjencie nuk ka ndodhur nga ndonjë agjenci shtetërore, por nga kompania private “Dardafon.net”. Kjo e fundit ka bllokuar llogaritë më 15 korrik për rastin e arbitrazhit ndërkombëtar me operatorin ekonomik “Dardafon”, në kuadër të të cilit është edhe shërbimi telefonik, i njohur me emrin “Z-Mobile”. Borxhi i Telekomit të Kosovës ndaj ‘Z-Mobile’ llogaritet të jetë mbi 25 milionë euro.



## Veliu nënshkruan të hënën marrëveshje bashkëpunimi me EUROPOL-in

PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme dhe EUROPOL-i do të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi. Marrëveshja do të nën-

shkruhet nga Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu. Ceremonia e nënshkrimit do të mbahet të hënën, më 27 korrik, duke filluar nga ora

10:00, në ambientet e objektit kryesor të MPB-së. Në ceremoni do të marrin pjesë edhe Nataliya Apostolova, shefe e Zyrës së BE-së/Përfaqësuese e

Posaçme e BE-së në Kosovë, Rashit Qalaj, drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, si dhe të ftuar të tjerë nga institucione vendore dhe ndërkombëtare.



## Selmanaj vlerëson lart rolin dhe kontributin e shoqërisë civile

PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Driton Selmanaj, ka pritur të premten në takim përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, me të cilat

ka diskutuar rreth Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike, projektligj ky i cili tanimë është edhe pjesë e

programit legjislativ për vitin 2020.

Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile u shprehën të gatshëm që të vazhdojnë të kontribuojnë në iniciativat

ligjore të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, duke ndihmuar kështu në draftimin e ligjeve. Zëvendëskryeministri Selmanaj i ka falënderuar të

gjithë pjesëmarrësit në këtë takim si dhe ka vlerësuar lart rolin dhe kontributin e shoqërisë civile gjatë gjithë procesit të hartimit të këtij projektligji.



## MPB-ja: Regjistrimi i automjeteve duhet të bëhet deri më 17 gusht



PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht Agjencia e Regjistrimit Civil, ka njoftuar qytetarët e Republikës së Kosovës, se pronarët e automjeteve të cilët nuk i kanë vazhduar regjistrimet apo nuk i kanë regjistruar automjetet e tyre për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia me Covid-19, duhet ta përmbushin detyrimin e tyre deri më 17 gusht 2020. "Deri me këtë datë ju vlen polica e sigurimit dhe certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të mjetit, pavarësisht afatit kohor. Pas kësaj date, detyrohen ta dorëzojnë

police e re të sigurimit, që nuk duhet të jetë më e vjetër se pesë (5) ditë nga data e lëshimit dhe certifikatën e re mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të mjetit, që nuk duhet të jetë më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga data e lëshimit. Për zbatimin e këtij afati do të kujdeset Policia e Kosovës", ka njoftuar MPB-ja.

Po ashtu, MPB-ja ka njoftuar qytetarët se të gjitha llojet e regjistrimit të automjeteve mund të bëhen në secilën qendër për regjistrimin e mjeteve të rajonit përkatës, pavarësisht prej vendbanimit apo vendqëndrimit të pronarit të automjetit.

## Kurti takon Apostolovën, e falënderon për bashkëpunim

PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Të premten në hapësirën e Muzeut të Kosovës, kryetari i IV-së, Albin Kurti, bashkë me deputeten dhe anëtarën e kryesisë, Fitore Pacolli, u takuan me shefen e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, dhe me këshilltaren e saj, Blerta Bejtullahu, për t'u përshëndetur para mbarimit të

misionit të Apsotolovës në Kosovë.

Gjatë këtij takimi lamtumirës, Kurti dhe Apostolova e falënderuan njëri-tjetrin për komunikimin e rregullt dhe për bashkëpunimin e mirë që kishin për këto katër vjet sa ishte në detyrë ajo. Gjithashtu, Kurti i uroi shumë suksese dhe punë të mbarë në angazhimet e reja të saj,

ndërsa ambasadorja tha se do të vazhdojë t'i përcjellë me vëmendje zhvillimet në Kosovë.

Të dyja palët shprehën dëshirë për të mbetur në kontakt të vazhdueshëm dhe Kurti shprehu gatishmëri për bashkëpunim mes Lëvizjes Vetëvendosje dhe shefit të ardhshëm të Zyrës së BE-së në Kosovë.



# Thaçi dhe Hoti, takim koordinues për dialogun dhe luftën kundër pandemisë

Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Avdullah Hoti janë takuar të premten dhe janë koordinuar rreth luftës kundër pandemisë Covid-19, për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë si dhe për çështje të tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, reformat dhe pakon ekonomike. Thaçi dhe Hoti kanë theksuar se procesi i dialogut me Serbinë nuk duhet të zbresë në nivel teknik

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të premten ka pritur në takim kryeministrin e Kosovës, Avdullah Hoti, me të cilin ka diskutuar për koordinimin ndërinstytucional në kuadër të luftës kundër pandemisë, për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë si dhe për çështje të tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, reformat dhe pakon ekonomike.

Presidenti Thaçi ka thënë se për vendin dhe për shoqërinë është jashtëzakonisht me rëndësi që bashkëpunimi ndërinstytucional të jetë efektiv. "Diskutua si ta tejkalojmë sa më mirë, sa më lehtë dhe sa më shpejt pandeminë, që të respektohen të gjitha rekomandimet e ekspertëve dhe të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë. Dhe në këtë drejtim duhet të punojmë të gjithë së bashku por, para së gjithash, të kemi një respektim të plotë prej të gjithëve, pa dallim, të masave që rekomandohen prej institutit", ka thënë presidenti Thaçi.

I pari i vendit përsëriti që e mirëpret emërimin e Skender Hysenit koordinator për

dialogun, ndërkaq theksoi se dialogu assesi nuk bën të rrëshqasë në nivel teknik. "Ne duhet ta qartësojmë raportin mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë, pra të ndodhë njohja reciproke dhe në asnjë rrethanë të mos lejojmë që ky proces të zbresë në nivel teknik, sepse raporti Kosovë - Serbi është kryekëput politik dhe jo teknik. Në nivel teknik nënkupton status-quo dhe respektim i agjendës së Serbisë", ka thënë Thaçi.

Ndërkaq kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se me presidentin kanë diskutuar në detaje për temat e interesit kombëtar.

"Diskutua gjerësisht për aktivitetet që po ndërmarrim si qeveri për ta menaxhuar situatën me Covid, për përfshirjen e të gjithë ekspertëve vendorë që i kemi në këtë proces, por edhe ekspertizën ndërkombëtare përmes OBSH-së, Komisionit Evropian dhe partnerëve zhvillimorë. E informova për veprimet që po i bëjmë përmes Ministrisë së Shëndetësisë, koordinimin që po e bëjmë me ekspertë të Ambasadës Amerikane dhe me ekspertë vendorë në këtë drejtim, për strategjitë që jemi duke i ndërtuar për t'u përballur me këtë situatë në periudha pak më afatgjata", ka thënë Hoti.

Ai ka treguar se diskutuan gjerësisht edhe për aktivitetet që po i ndërmarrin për ta ndihmuar ekonominë dhe sektorin privat nëpër situatën në të cilën po kalon. "Më vjen mirë që Kuvendi i ka miratuar marrëveshjet ndërkombëtare që janë pjesë e programit tonë për rimëkëmbje ekonomike. Unë pres që në ditët e ardhshme Kuvendi ta miratojë edhe rishikimin e buxhetit dhe Ligjin për rimëkëmbje ekonomike, që tashmë e kemi dorëzuar në Kuvend. Unë do të kem diskutime të ngushta me të gjitha partitë politike pa përjashtim për t'i marrë propozimet e tyre për Ligjin për rimëkëmbje ekonomike, sepse vërtet është ligj i rëndësishëm nacional dhe unë pres dhe kërkoj me mirëkuptim që me të gjithë deputetët dhe grupet parlamentare, t'i kryejmë edhe

këto dy punë, rishikimin e buxhetit dhe Ligjin për rimëkëmbje ekonomike përpara se Kuvendi të shkojë në pushime të verës", ka thënë Hoti, duke shtuar se me presidentin kanë diskutuar edhe për dialogun Kosovë - Serbi. "Tema tjetër që e diskutua me presidentin është dialogu me Serbinë. E informova presidentin për veprimet që i kemi ndërmarrë deri më tash, për aktivitetet që kanë ndodhur deri më tani nga Samiti i Parisit, si dhe në takimet e tjera përmes video-konferencës dhe takimit në Bruksel. E falënderoj presidentin për mirëkuptimin që e ka pasur për koordinatorin shtetëror për dialog. Një person që ka përvojë të madhe në proceset e ndryshme të shtetndërtimit të Kosovës. Ai flet në emër timin në këtë proces të dialogut. Ne do të

sigurohemi që të gjithë së bashku që në asnjë moment dialogu të mos rrëshqasë në nivel teknik, por ta mbajmë të fokusuar në objektivin tonë kryesor që është njohja reciproke për normalizimin e marrëdhënieve. Po përpiqemi që ta bëjmë maksimumin për koordinimin e të gjitha aktivitetëve me partnerët tanë ndërkombëtarë, sepse është tepër jetike që të jenë të përfshirë të gjithë", është shprehur Hoti. Ai ka theksuar se është një momentum shumë i mirë pasi, sipas tij, tashmë në këtë proces kemi vëmendjen e vendeve kyçe të BE-së, Gjermanisë e Francës në veçanti, por edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikë. "Mbes me shpresë që në muajt e ardhshëm ta përmbyllim këtë proces me sukses", është shprehur kryeministri Hoti.


## Lajçak i quan produktive bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë



PRISHTINË, 24 KORRIK - I dërguari i Posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter", ka thënë se "diskutimet politike të kësaj jave (Kosovë - Serbi) në nivel ekspertësh mbi personat e zhdukur dhe personat e zhvendosur ishin produktive dhe konstruktive. "Mezi presim raundin tjetër të bisedimeve ndërmjet ekspertëve", ka thënë Lajçak, duke paralajmëruar vazhdimin e dialogut së shpejti, pa dhënë një datë. Më 16 korrik kryeministri Avdullah Hoti u takua në Bruksel me ndërmjetësimin e

BE-së me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Ky ishte takimi i parë, pas 20 muajsh të ndërprerjes së dialogut. Pas këtij takimi, delegacionet e ekspertëve të të dyja vendeve më 23 korrik u takuan në Bruksel. Në këtë takim Kosova u përfaqësua nga koordinatori shtetëror për dialog, Skender Hyseni dhe palën serbe e përfaqësoi shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq. Paralajmërimet se ky takim i ekspertëve nënkupton rinisjen e dialogut teknik që nisi më 2011 dhe që u pasua më pas me dialogun në nivel politik nuk janë mirëpritur në Prishtinë.

## OEA organizon trajnim për shitje online



Prishtinë, 24 korrik (ER) - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar një trajnim virtual mbi shitjen online dhe komunikimin digjital me kryeshefin ekzekutiv të kompanisë "Hallakate", Valon Canhasi.

Nëpërmjet këtij trajnimi anëtarët e Odës Amerikane patën mundësinë t'i zhvillojnë njohuritë rreth shitjes online dhe pranisë në internet si dhe t'i eksplorojnë mënyrat se si

mund të shfrytëzohet interneti në përgjithësi për fushën e shitjeve.

Kryeshefi ekzekutiv i "Hallakate", Valon Canhasi, ndau me pjesëmarrësit e këtij trajnimi statistikën e fundit të përdoruesve të internetit në Kosovë, të cilat kohët e fundit kanë arritur shifrat më të larta ndonjëherë.

Canhasi ka theksuar se bizneset tanimë janë në një luftë konstante për ta tërhequr vëmendjen e konsumatorëve

përmes promovimit të shërbimeve dhe produkteve të tyre në internet, gjithmonë duke u përshtatur me audiencën së cilës synojnë t'i shërbejnë, duke ndjekur trendët e fundit dhe ndryshimet e shprehive të konsumit.

Ai ka potencuar se koncepti i shitjeve nëpërmjet internetit, megjithëse procesi relativisht i vështirë për t'u arritur, krijon mjaft lehtësira në fushën e të bërit biznes pasi lejon qasje më të lehtë në produktet dhe

shërbimet të cilat i ofrojnë bizneset në çdo kohë, pa pasur nevojë për kontakt fizik. Sipas Canhasit, prania digjitale krijon lehtësira në menaxhimin e biznesit duke ofruar qasje në të dhëna nga distanca.

Gjatë këtij trajnimi Canhasi ndau me pjesëmarrësit një strategji për krijimin e platformës së shitjeve online, duke zbërthyer hap pas hapi veprimet që duhet të ndërmerren drejt krijimit të një platforme të suksesshme. Sipas

tij, kjo strategji përfshin identifikimin e tregut, analizën e mirëfilltë të kërkesës dhe nevojave të klientëve dhe përshtatjen e promovimit të biznesit në platformat më të përdorura nga audiencia e targetuar.

Ai ka veçuar nevojën për ngritje të vetëdijes rreth mundësive që ofrojnë bankat dhe bizneset për shitje online, sidomos gjatë kësaj kohe kur kontakti fizik me klientët është pothuajse plotësisht i limituar.

## 'Qytetarë të papërgjegjshëm po kyçin kanalizimet në kanalet kabllorike të KEDS-it'



PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - "Qytetarë të papërgjegjshëm po bëjnë veprime kriminale duke kyçur kanalizimet e tyre në kanalet kabllorike të KEDS-it ku janë kabllot që furnizojnë qytetarët me energji elektrike. Kjo po rrezikon furnizimin me energji elektrike, sigurinë e sistemit, sikurse sigurinë e qytetarëve", është bërë me dije në një komunikatë të KEDS-it. Sipas kësaj komunikate, një rast

konkret që ndërlidhet me këtë fenomen të papranueshëm ka ndodhur së fundmi në lagjen Veternik (magjistralla Prishtinë-Gjilan), ku një qytetar është kyçur me rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza në kanal kabllorik të KEDS-it. "Ekipet e kompanisë kanë intervenuar menjëherë duke bërë pastrimin e kanalit dhe zëvendësimin e stabilimentit në mënyrë që konsumatorët e asaj

ane të mos mbesin pa furnizim me energji elektrike. Raste të tilla po ndodhin vazhdimisht në lagje të ndryshme të Prishtinës. KEDS-i u bënë me dije qytetarëve që veprime të tilla janë vepra penale reptësisht të ndaluara. Ftojme organet e rendit dhe të drejtësisë që të merren me këto raste në mënyrë që të mos përsëriten në të ardhmen", është theksuar në komunikatën e KEDS-it.

## Vlerësohet i domosdoshëm plotësim-ndryshimi i Ligjit për Automjetet

PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka pritur të premten në takim drejtuesit e Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, me të cilët ka diskutuar për bashkëpunim në aspektin e sigurisë së komunikacionit. Ministri Abrashi ka shprehur gatishmëri për të bashkëpunuar me këtë shoqatë në aspektin e legjislacionit që mundëson anëtarësimin e Republikës së

Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Temë e takimit ishte edhe digjitalizimi i sigurisë së rrugëve dhe zhvillimi i kampanjave të përbashkëta për rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve për sigurinë në trafik. Ndërsa drejtori i kësaj shoqate, Sami Mazreku, ka thënë se është domosdoshmëri plotësim-ndryshimi i Ligjit për Automjetet.



# Dështojnë propozim-rezolutat për Telekomin dhe pensionistët



Në mungesë të kuorumit, Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur të premten që ta miratojë propozim-rezolutën për Telekomin e Kosovës dhe atë për të drejtat e pensionistëve kontributdhënës

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 KORRIK - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar t'i votojnë dy propozim-rezolutat e sjella në Kuvend nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Propozim-rezoluta e LV-së kishte të bënte me Telekomin, përkatësisht situatën financiare të kësaj ndërmarrjeje, por që mori vetëm 29 vota nga 74 deputetë sa ishin në sallë.

Në propozim-rezolutë thuhet se: "Kontrata 'Dardafon' - Telekom e vitit 2009 ka elemente të mjaftueshme për t'u hetuar penalisht. Qeveria ta zbatojë vendimin mbi masat për parandalimin e keqpërdorimeve në ndërmarrjet publike si dhe ta shqyrtojë mundësinë e plotësimit të tyre. Qeveria të ndërmarrë masa konkrete për ta mbrojtur Telekomin nga kreditorët e pandërgjegjshëm me qëllim të stabilitetit financiar të Telekomit të punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje", thuhet në rezolutën e propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje e cila nuk mori përkrahjen e deputetëve. Xhirlogaritë e Telekomit të Kosovës u bllokuan më 15 korrik për rastin e arbitrazhit ndërkombëtar me operatorin ekonomik 'Dardafon', në kuadër të të cilit është edhe shërbimi telefonik i njohur me emrin 'Z-Mobile'.

Telekomi i Kosovës dhe kompania 'Z-Mobile' në vazhdimësi kanë pasur mosmarrëveshje në lidhje me një kontratë të nënshkruar

dhjetë vjet më parë, e cila i kishte mundësuar kompanisë 'Z-Mobile' të ishte operatorja virtuale e telefonisë mobile të operatorit mobil 'Vala', që funksionon në kuadër të Telekomit të Kosovës.

Mospajtimet mes palëve kishin nisur kur 'Z-Mobile' kërkoi numra shtesë. Çështja kishte shkuar në arbitrazh dhe më pas Gjykata e Prishtinës kishte vendosur në favor të kompanisë 'Z-Mobile'. Bërxhi i Telekomit të Kosovës ndaj 'Z-Mobile' llogaritet mbi 25 milionë euro. Kurse propozim-rezoluta e propozuar nga AAK-ja, përkatësisht deputetja Teuta Haxhiu për pensionistët kontributdhënës, mori vetëm 48 vota.

Deputetja e AAK-së, Teuta Haxhiu, ka kërkuar në Kuvendin e Kosovës të zgjidhet çështja e pensionistëve kontributdhënës, të cilëve nuk u njihet stazhi i punës që nga paslufta, por vetëm stazhi i punës para vitit 1999. Haxhiu në fjalën e saj ka thënë se do ta paraqesë një rezolutë në Kuvendin e Kosovës për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Ajo ka thënë se këto dispozita ligjore, të bazuara në ligjet e ish-Jugosllavisë, diskriminojnë kontribuuesit.

Deputetja Haxhiu ka theksuar se po përfitojnë pikërisht ata që i ishin nënshtruar sistemit në atë kohë ngaqë vetëm ata nuk ishin larguar dhunshëm nga puna. "Si rrjedhojë e këtyre fakteve, ka shumë pak kontributdhënës që mund ta plotësojnë periudhën 15-vjeçare. Ka shumë prej tyre që për disa javë nuk e plotësojnë këtë kriter. I bie që ai ka punuar

gjithë ato vite dhe ai nuk gëzon pensionin dhe kontributin e tij dhe merr një pension sikur dikush që nuk ka punuar fare, pra pension i moshës", ka thënë Haxhiu.

Më tutje, ajo ka propozuar se secilit duhet t'i njihet stazhi i punës dhe secili duhet të paguhet për atë kontribut sa ka dhënë. "Është mirë që secili të paguhet për vitet e punës. Pra, për atë vite sa kanë punuar, për atë vite të paguhet. Në rezolutën që do ta paraqes sot jam e sigurt se të gjitha grupet parlamentare kanë ndjeshmëri për këta pensionistë. Më shumë sinqeritet pres nga të gjitha grupet parlamentare që ta bëjmë një zgjidhje", është shprehur Haxhiu.

Shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka theksuar se janë "pro" heqjes së kufizimit për të përfituar pensionistët kontributdhënës por, sipas tij, kjo çështje mund të përfundonte me një akt administrativ nga një ministër, pa pasur nevojë për Kuvend.

Ai gjatë seancës së Kuvendit, duke e quajtur Haxhiun deputetë të "mazhorancës", i ka bërë thirrje kësaj të fundit t'i drejtohet qeverisë pasi, siç ka thënë ai, kjo e fundit ka ngatërruar adresën. "Ne si LV jemi që kjo çështje të zgjidhet. Jemi, po ashtu, që ky udhëzim administrativ t'i heqë kufizimet për të përfituar pensionistët kontributdhënës. Ajo çka po kërkohet nga Kuvendi mund ta bëjë ministri. Thirrësi i kësaj seance është dashur ta kërkojë këtë vetëm nga qeveria. Nuk po e

## Reçica i bindë deputetët për ta përkrahur iniciativën për të drejtat e pensionistëve

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në seancën e së premtes në Kuvendin e Kosovës, ka arritur që në fund të debatit parlamentar për të drejtat e pensionistëve kontributdhënës t'i bindë deputetët e të gjitha grupeve parlamentare për ta përkrahur nismën që e mundëson jetësimin e njërës nga prioritetet e tij kryesore, pra plotësim-ndryshimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti. Ministri Reçica ka deklaruar se me këto ndryshime ligjore do t'u njihet stazhi i punës gjithë të punësuarve të viteve '90, të dëbuar me dhunë nga puna nga pushteti serb. "Ky plotësim-ndryshim prek një numër të konsiderueshëm të pensionistëve kontributpagues, që nuk është me rëndësi numri, por po flasim për një padrejtësi që u është bërë 20 vjet pas luftës këtyre kategorive. Pra, unë mendoj se ka ardhur koha që kjo padrejtësi të hiqet dhe në

vitin 2021 pensionistët tanë kontributpagues ta fillojnë vitin duke mos e pasur këtë pengesë në realizimin e të drejtës së tyre për përfitimin dinjitoz të një pensioni kontributpagues", është shprehur Reçica.

Gjithashtu, ministri Reçica ka thënë se në kuadër të plotësim-ndryshimit kanë paraparë që të hiqet ndalesa për pensionistët kontributpagues në rast se janë familjarë dëshmorë ose invalid luftime, që të kenë të drejtën ta gëzojnë pensionin kontributpagues dhe njëkohësisht përfitimin i cili buron nga Ligji për kategoritë e dala nga lufta.

Në këtë seancë parlamentare ministri Reçica ka kërkuar dhe ka marrë përkrahje nga deputetët për ta mbështetur me votë këtë plotësim-ndryshim të ligjit sapa të vijë në Kuvend. Sipas tij, ai do të procedohet për miratim në qeveri deri më 30 korrik të këtij viti.

kuptoj si një deputet i mazhorancës kërkon nga Kuvendi një gjë të cilën me një akt administrativ mund ta bëjë qeveria. Zonja Haxhiu, drejtohuni qeverisë suaj. Nuk po kuptoj çka po kërkon nga ne. E ke adresën e gabuar. Nuk është kjo dera që zgjidh këtë problem", ka thënë ai.

Deputeti nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, Sejdi Hoxha, ka thënë se qytetarët kontributdhënës që kanë punuar në vitet '90 kanë të drejtë ta gëzojnë pensionin e tyre. Ai ka

thënë se punëtorët e kësaj periudhe u dëbuan me dhunë nga puna e tyre dhe është obligim moral e ligjor të rregullohet çështja e tyre. "Kemi obligim ligjor dhe moral ta rregullojmë çështjen e pensionit kontributdhënës të viteve të para luftës. Njohja e kontributit pensional është e drejtë ligjore e të gjithë kontributdhënësve që shumica nga ta ishin dëbuar me dhunë nga puna në vitet '90a. Shumë nga ta janë edhe çlirues të Kosovës që iu bashkëngjiten UÇK-së", është shprehur Hoxha.

## Bëhet përrurimi i zyrës së gjendjes civile në Mushnikovë

PRIZREN, 24 KORRIK (ER) - Me pjesëmarrjen e kryetarit të Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, nënkryetarëve dhe drejtorëve komunalë, është bërë përrurimi i Zyrës së Gjendjes Civile në Mushnikovë, projekt i realizuar nga Drejtoria e Administratës.

Ndërtesa e Zyrës për Gjendje Civile në këtë fshat ishte shumë e vjetër dhe e dëmtuar. Për këtë arsye Komuna e Prizrenit ka realizuar projektin

për ndërtimin e zyrës së re, me pamje që i përshtatet arkitekturës së shtëpive të vjetra në Mushnikovë, por me një ambient të brendshëm modern e funksional.

Me këtë investim Komuna e Prizrenit ka plotësuar kërkesën e hershme të më shumë se 6 000 banorëve nga fshatrat e rajonit të Mushnikovës ku, përveç kushteve më të mira për stafin administrativ, do të ketë edhe shërbime më efikase për qytetarë.



## Vushtrria dhe OJQ Stray Coco do të nënshkruajnë memorandum për strehim të përkohshëm të qenve endacakë

VUSHTRRI, 24 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka vizituar North Animal Hospital, qendër ditore për trajtimin e qenve endacakë dhe strehimore e përkohshme e cila udhëhiqet nga Zenel Zhabari.

Komuna e Vushtrrisë dhe OJQ Stray Coco do të nënshkruajnë memorandum dyvjeçar për trajtim dhe strehim të përkohshëm të qenve endacakë në këtë qendër.

Kjo është qendra e dytë e këtij lloji në Kosovë.

## Ministri Likaj: Malisheva, model i mirë i mësimin online

MALISHEVË, 24 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, e kanë pritur të premtën në takim pune ministrin e Ministrisë për Arsim dhe Shkencë, Ramë Likaj, me të cilin kanë biseduar për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor dhe për çështje të tjera në arsimin e Malishevës.

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, pasi e ka falënderuar për vizitën, e ka njoftuar ministrin me investimet e komunës në infrastrukturën shkollore, përderisa ka shtruar edhe nevojën e përmirësimit të gjendjes së përgjithshme në arsim. "Ne kemi investuar shumë objekte shkollore me qëllimin e vetëm: që t'i përmirësojmë kushtet në shkollat tona dhe me këtë të rritet cilësia në arsim. Kërkoj nga ministria që ta ndihmojë më shumë Malishevën në fushën e arsimit", ka thënë Begaj.

Ndërsa drejtori i Arsimit në



Malishevë, Blerim Thaçi, e ka njoftuar ministrin me gjendjen aktuale të shkollave, me përfundimin e procesit mësimor dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. "Ne i kemi mbi 70 për qind të objekteve shkollore që punojnë me një ndërrim dhe jemi duke u angazhuar që të gjitha shkollat të punojnë me një ndërrim, ndërsa sa i përket përfundimit të procesit mësimor, ne me sukses e kemi përfunduar këtë vit, pasi kemi krijuar edhe platformën digjitale për mësimin online dhe jemi duke u përgatitur edhe për fillimin e vitit të ri shkollor", ka deklaruar drejtori

Thaçi. Ministri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, e ka përshëndetur platformën digjitale të mësimin online, duke e vlerësuar Komunën e Malishevës si njërin prej më të suksesshme në këtë drejtim dhe, sipas ministrit, Malisheva dhe Prishtina janë modele më të mira të mësimin online me këtë platformë. Më pas ministri është interesua edhe për nevojat që ka Malisheva në fushën e arsimit, përkatësisht për nevojat që kanë shkollat, për çerdhet dhe për çështje të tjera, për të cilat drejtori i arsimit, Blerim Thaçi, e ka njoftuar në hollësi.

## Vazhdon shtrirja e rrjetit të kanalizimit në Radulloc, Ranoc-Leskoc dhe Jagodë të Klinës

KLINË, 24 KORRIK (ER) - Në fshatrat Radulloc, Ranoc-Leskoc dhe Jagodë të Komunës së Klinës po vazhdon faza e dytë e punimeve për shtrirjen e rrjetit të kanalizimit.

Realizimin e punimeve e kanë përcjellë nga afër kryetari i komunës, Zenun Elezaj, i shoqëruar nga drejtori i Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Lorenc Marleku.

Elezaj ka theksuar se rrjeti i kanalizimit ka qenë një nga problemet më të mëdha me të cilën janë përballur qytetarët e

këtyre fshatrave por, pas investimeve që janë realizuar vitin e kaluar dhe vazhdimin të projektit në këtë vit, tashmë po përmbushet një nga kërkesat kryesore dhe më të nevojshme për qytetarët e kësaj ane.

Projektet për shtrirjen e rrjetit të kanalizimit në këto fshatra financohen nga Komuna e Klinës, ndërsa vlera e projekteve janë këto: Në fshatin Radulloc 27 989 euro, në fshatin Jagodë 32 567 euro, ndërsa projekti për fshatrat Ranoc-Leskoc ka një vlerë buxhetore prej 27 505 eurosh.



# NË KOSOVË LINDI RINGRITJA SHQIPTARE (16)



**Shkruan: Kudosu LAMA**

Megjithatë, është e ditur se Serbia në tërë jetën e saj si komb dhe si shtet vazhdimisht ka arritur që të sigurojë mbështetje nga shumë shtete të mëdha të Evropës. Kjo ka ardhur si rezultat e lidhjes së qëndrimeve politike me interesat ekonomike. Këto interesa kanë krijuar një klimë proserbe në praktikën e politikës evropiane, që ta krijojë idenë e hidhur të një miqësie midis tyre, e cila shkon deri në verbëri totale të kësaj politike ndaj veprimeve serbe kundër popullit të Kosovës.

Janë dy çaste që tregojnë qartë se prej fillimit politika ndërkombëtare i beson shumë Serbisë, prandaj edhe heziton të marrë një qëndrim të drejtë ndaj luftës së Kosovës.

Së pari, fakti që Serbia me zjarr dhe me hekur u sul mbi Kosovën, duke vrarë dhe djegur shqiptarët, pa dallim moshe a seksi dhe askush nuk mori përgjegjësi t'i thotë "ndal", tregon më së miri se sa e paqartë ishte kjo politikë rreth ngjarjeve në Kosovë.

Së dyti, fakti se që në çastet e para, pa asnjë të drejtë logjike e gjuhësore, pothuajse të gjithë i emërtuan luftëtarët e UÇK-së si terroristë dhe veprimtarinë luftarake të tyre si terrorizëm, nuk ishte gjë tjetër veçse firmosje e lejes për Serbinë që ta shuante Kosovën.

Masakrat serbe në Kosovë, nën moton e luftës për çrrënjosjen e terrorizmit dhe separatizmit shqiptar, duket se u inspiruan pikërisht nga këto qëndrime tolerante dhe në njëfarë mënyre përkrahëse nga ana e faktorit politik ndërkombëtar.

Meritat e Kosovës me luftën e bërë nga Ushtria Çlirimtare, në të cilën militanët djemtë dhe vajzat më të mirë të truallit, janë me vlera të jashtëzakonshme për ardhmërinë kombëtare.

Tentativat destabilizuese në trojet shqiptare në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX morën një përgjigje përfundimtare nga Kosova, e cila i tha jo destabilizimit shqiptar, i tha jo robërisë dhe i tha jo shtypjes e asimilimit.

Me asnjë lloj morali, Serbia nuk ishte larguar nga Kosova, ndërsa përballë forcës së armëve shqiptare u detyrua të bëjë hapa prapa sa që doli jashtë kufijve të Kosovës. Pikërisht kjo forcë shqiptare solli në Kosovë gjithë fuqinë politike dhe ushtarake botërore.

Në Kosovë lindi ringritja

shqiptare. Prej atje lëshohen mesazhe për Republikën e Shqipërisë, për t'i marrë më mirë në dorë frenat e shtetit amë, për të marrë përsipër misionet të mëdha në interes të kombit, njëkohësisht për t'u bërë pasqyra e trojeve shqiptare për zhvillim e ardhmëri.

Pra, është Lufta Çlirimtare e Kosovës dhe ndikimi i saj jo vetëm mbi armikun e saj shekullore, Serbinë, por edhe mbi politikën dhe diplomacinë ndërkombëtare që bëri të ndryshojnë pozicionet.

Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka meritë të madhe sepse që në hapat e parë, luftën në Kosovë nuk e bëri një luftë të mbyllur, por një luftë të hapur për të gjithë shqiptarët, pa dallim pikëpamjesh, ndarjesh, krahinash a feje. Që në hapat e parë, kjo ushtri mori përsipër dy obligime të mëdha: së pari, ta godiste fort armikun dhe ta detyronte të kthehej në vendin e tij; së dyti, ta ndërrojë popullin se pa luftë të armatosur nuk mund të kishte çlirim nga Serbia dhe se pa pjesëmarrjen masive të djemve dhe të vajzave të Kosovës në këtë luftë, nuk mund të kishte ardhmëri për Luftën Çlirimtare dhe për Kosovën e lirë.

Beteja sublime e Jasharëve ishte preludi i ditëve të ardhshme të Kosovës heroike për lirinë e saj. Adem Jashari me luftën e tij dhe të familjes së tij bëri epokë. Epopeja e kësaj luftë ka mbetur në piedestalin e Kosovës, si një faqe e lavdishme e të ardhmes. Këtu te ky prag i Jasharëve fillon e ardhmja kombëtare shqiptare. Në këtë betejë titanësh, çdo gjë ishte llogaritur shumë mirë. Rënia e gjithë pjesëtarëve të familjes së Shaban Jasharit në altarin e lirisë nuk ishte një rastësi, as një pakujdesi, por ishte një vetëdije e plotë e kombit. Në këtë betejë, në këtë familje zëmadhe, u shpalo më i plotë se asnjëherë arsenalin e dashurisë për atdheun dhe i sakrificës sublime për lirinë.

Adem Jashari i kishte të gjitha mundësitë që t'i shpëtonte pjesëtarët e familjes së tij, i kishte të gjitha mundësitë që edhe vetë të shmangej nga kjo mënyrë ndeshjeje me ushtrinë dhe policinë masive serbe. Por, ai e kishte parashikuar mirë perspektivën e Kosovës. Ai e donte aq shumë Kosovën e lirë sa me gjakftohtësi kishte vendosur ta shikonte jo si qytetar, por nga piedestali i krenarisë kombëtare dhe, jo vetëm, por me të gjithë anëtarët e familjes së tij, pa dallim moshe a gjinie.

Ky vendim i Adem Jasharit kishte një vlerë të madhe për ardhmërinë e Kosovës. Ai e kishte kuptuar mirë se për Kosovën duhej një betejë prelud. Duhej një pushkë që të kërciste fort, që të dëgjohej në të gjitha anët. Duhej një sakrificë e

madhe që të ngjethte ata që e quanin veten njerëz.

Fat i keq për atë shqiptarë që nuk e kanë dëgjuar këtë thirrje të madhe të Adem Jasharit.

Lufta tregoi se populli i Kosovës e kishte kuptuar mirë Adem Jasharin. E kishte marrë mesazhin e tij dhe i dha mijëra djem e vajza ushtrisë së tij. I dha mbështetjen dhe uratën për ditët e bardha të së ardhmes.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës mori të tilla përgjegjësi, që në tavolinat e mëdha të politikës dhe të diplomacisë së madhe evropiane e botërore do të ishte diskutuar gjatë dhe nuk do të ishte arritur të vendosej për t'i marrë ato përgjegjësi, që mori ajo ushtri e shqiptarëve në kushtet kur dhe si i mori për interesat e atdheut e popullit të vet.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk u krijua nga një dëshirë monarku, nga një urdhër gjenerali, nga një vendim parlamenti a nga një dëshirë e një aventurieri. Ajo lindi nga pjekuria politike e popullit të Kosovës për identitet kombëtar dhe vullneti i tij për të fituar lirinë dhe pavarësinë nga pushtuesi shekullor me forcën e armëve dhe me sakrificë ekstreme, në pamundësi për t'u marrë vesh paqësisht e ndarë atë që i takonte Kosovës e popullit të saj.

Një nga parimet bazë të Luftës Çlirimtare të Kosovës ishte vullnetarizmi në krijimin e ushtrisë së nevojshme. Pikërisht këtu duket më së miri pjekuria politike e popullit të Kosovës, prej këtu del edhe përfundimi se ky popull e meritoj, plotësisht lirinë e tij.

Vullnetarizmi, si parim bazë i furnizimit të UÇK-së me forcë njerëzore luftarake, ka luajtur një rol të rëndësishëm në besimin e popullit. Por këtë nuk mund ta kuptojnë ata që sot na i akuzojnë djemtë në gjyqe ndërkombëtare, si mbështetje të gjykimeve që akoma vazhdon t'i bëjë Serbia në mungesë.

Duhet ditur se një luftë qoftë edhe e një ushtrie të kufizuar e me afat të shkurtër shtrirjeje të jetë, ka nevojë për mbështetje. Këtë mbështetje e ka në terren.

Ajo forcë ushtarake që ka terrenin me vete, e ka të sigurt edhe fitoren. Një ushtri sado e madhe të jetë, por që humbet kontaktin me terrenin nuk arrin të kontaktojë më me qytetërimin, sepse asgjësohet totalisht, pa bërë asnjë betejë, sepse humbet moralin e të qenit ushtri.

Pra, duket se një forcë mund të quhet ushtri dhe ta ndiejë veten ushtri vetëm në marrëdhënie me terrenin, pra, me popullin që banon tokën ku zhvillohet lufta.

Në Kosovë populli shqiptar ishte shpirti i Luftës Çlirimtare, kështu që normalisht do të ishte edhe bazë e kësaj lufte.

Veprimtaria popullore në interes të luftës në Kosovë, kishte vlera të mëdha se ajo ishte e domosdoshme në këto fusha: Së pari, UÇK-ja duhet të ushqejë çdo ditë me gjak të ri; së dyti, kjo ushtri duhej të dinte se populli prej gjirit të të cilit doli ishte i qëndrueshëm, ndaj duhet të ishte i qetë dhe i bashkuar për të përballuar gjithë rrebeshin fashist serb; së treti, UÇK-ja kishte nevojë për armë; së katërti, në luftë kishte të plagosur që duheshin kuruar; së pesti, kjo ushtri donte bukë; së gjashti, faktorët që sollën fitoren mbi armikun në Kosovë ishin Lufta Çlirimtare heroike e ushtrisë më të re në botë dhe deklarimi në opinionin ndërkombëtar i reprezaljeve dhe i krimeve të serbëve mbi popullin e Kosovës. Pra, ky popull është jo vetëm ushqyes i ushtrisë së tij dhe luftës së saj, por edhe bashkëfitimtar i kësaj lufte me heroizmin e treguar para bishave serbe. Së shtati, ky popull ktheu në momente uniteti e demonstrimi të vullnetit të lirisë, me gjithë sakrificat që bartte, edhe momentet e përmortshme të varrosjes së viktimave dhe të martirëve e dëshmorëve. Së teti, ky popull i besoi UÇK-së si diellit, si dritës, si ajrit, pa të cilat nuk mund të kishte jetë. Filozofia e këtij populli u bë liria dhe mjeti i realizimit të saj, UÇK-ja.

Këto i kam deklaruar edhe herë të tjera, por desha t'i freskoj edhe njëherë në kujtesën e atyre që kanë rënë në letargji e kujtojnë se liria erdhi si dhuratë. Lufta ka vazhduar gjatë në Kosovë. Por edhe përkundër vazhdimësisë së saj, ajo nuk arriti dot të institucionalizohet si një luftë e përgjithshme përgjatë gjithë historisë së Kosovës së pushtuar nga Serbia. Pikërisht, këtu qëndron edhe forca e Luftës Çlirimtare të Kosovës, ngaqë ajo arriti të ngrrej jo vetëm opinionin e brendshëm, por edhe atë ndërkombëtar, duke u kthyer në një luftë të përgjithshme, që përfshiu në kohë të shkurtër gjithë Kosovën.

Në Kosovë kishte shumë vite që gatuhej kjo luftë. Amvisa e gatimit të saj natyrisht se ishte Serbia. Ajo me regjimin e saj donkishotesk, nuk arriti për asnjë moment që të mirëkuptohej me këtë popull, që historia e kishte lënë padrejtësisht në bashkëjetesë me të, duke e shkëputur nga trunghi i shtetit amë. Natyrshëm, në kushtet e një shtypjeje të pashembullt; në kushtet e një gjenocidi të pashoq; në kushtet e pasigurisë më elementare për jetë; në kushtet e varfërisë dhe të diskriminimit; në kushtet e shpronësimit të vazhdueshëm e të përzënies nga trojet e tyre me të gjitha mënyrat, që nga

mashtrimi e deri tek asgjësimi, nuk mund të pritej gjë tjetër veçse ndeshje e armatosur.

Sipas vlerësimeve, nuk kishte alternativë tjetër përveç luftës që mund ta vendoste çlirimin e popullit të Kosovës nga sundimi serb.

Lufta Çlirimtare e Kosovës erdhi si flamurtare për t materializuar jetën kombëtare shqiptare.

Serbia, e cila kishte investuar për ta zhdukur Kosovën, ishte më se e qartë se nuk mund të gjente mirëkuptim për ta lënë të lirë atë.

E megjithëse dihet se lufta me armë është elementi më i papranueshëm për jetën e një shoqërie njerëzore, ja që kushtet e papërgjegjësisë nacionale e diktojnë atë. Në këto kushte Lufta Çlirimtare e Kosovës ka ardhur jo si një dëshirë, por si një domosdoshmëri.

Lufta Çlirimtare e Kosovës do të udhëtojë nëpër jetën kombëtare shqiptare, si një tregues drejt ardhmërisë, sepse ishte akti më i arsyeshëm për sigurimin e çlirimit nga pushtimi dhe ishte elementi kryesor që largoi sundimin shekullor serbo-sllav. Ndër arsyet pse dalim në këtë përfundim konsideroj: Kosova ishte e pushtuar; Jeta në Kosovë ishte bërë e padurueshme; Kosovës po i hiqeshin të drejtat e të qenit komb shqiptar; Politika serbe në vazhdimësi ishte politike shoviniste; Askush nuk e kishte jetën të sigurt, vrasjet dhe zhdukjet ishin modë e ditës; Toka e Kosovës po përvetësohej nga serbët; Pasuria e Kosovës shkonte në Serbi; Politika serbe ishte politikë e asimilimit dhe e shpërnguljes masive të shqiptarëve, e mbështjellë me kolonizim masiv të Kosovës me serbë; Inteligjencia kosovare diskriminohej në vazhdimësi; Arsimi shqip u eliminua; Populli i Kosovës konsiderohej dhe trajtohej si një tepricë njerëzore; Politika kosovare nuk përfillej nga pushtuesi; Kërkesat u shpërfillën të gjitha; E drejta e punës ishte vetëm në ata sektorë që kërkonin punë të klasës së fundit; Politika serbe që e quante Kosovën - Serbi e Vjetër mori përmasa shumë të mëdha; Doli në plan të parë asgjësimi i shqiptarëve; Mirëkuptimi nuk u pranua në asnjë nivel pushteti nga serbët; Demonstratat dhe protestat u mbytën me gjak; U nëpërkëmb nderi shqiptar në përgjithësi dhe i çdo familjeje në veçanti; Serbët e Kosovës në vazhden e politikës së Beogradit u kriminalizuan në shumicë, duke u bërë të rrezikshëm për bashkëjetesë etj.

(Vijon)

# ALI AHMETI NE HAGE



**Ismet SYLEJMANI**

*Lajm i madh!*

*Lajm që përhapet me shpejtësi zëri!*

*Gjemojnë mjetet e informimit, të shkruara dhe elektronike!*

*Edhe Ali Ahmetit i është dorëzuar ftesa për në Gjyqin e Hagës!*

*Është ftuar në Hagë edhe Ali Ahmeti!*

*Haga e fton Ali Ahmetin dëshmitar!*

*Ali Ahmeti ka pranuar dhe do të shkojë në Hagë!*

Në Hagë janë shokët, bashkeveprimtarët dhe bashkëluftëtarët e Tij!

Në Hagë janë ftuar disa nga themeluesit e UÇK-së!

Ali Ahmeti edhe me Hagën tregon se është biri i madh dhe udhëheqësi i lavdishëm i popullit shqiptar!

Gjykata Speciale thërret për të dëshmuar udhëheqësin e shquar të LPK-së, njërin prej themeluesve të parë të UÇK-së dhe Anëtarin e Shtabit Qëndror të sajë, shqiptarin me shtat të vogël por me zemër të madhe Ali Ahmetin!

Te Ali Ahmeti, te kjo krijesë e famshme, qëndron një thesar i madh i Atdheut e Kombit, sepse në ballë të popullit shqiptar, është vënë lavdindrituri, dhe në udhëheqje të shqiptarizmës dirigjon me shkathësi e profesionalizëm, prej politikani patri-

ot e veprimtari kombëtar, që shtetin dhe funksionimin ligjor i ka për popullin e Atdheun!

Ali Ahmeti, shtetin e ka para pushtetit personal politik dhe partiak, epërsi këto që Kombit të Tij ia rritë nderin dhe famën për çdo ditë, që në Maqedoninë e Veriut tokën e Atdheut të të parëve të tij e ruan si sytë e ballit!

Ali Ahmeti njëri ndër themeluesit e UÇK-së, UÇPMB-së dhe i UÇK-së në Maqedoni, do të shkëlqejë në Tribunalin Ndërkombëtar, do ti tregojë gjithë botës se ka zot populli shqiptar!

Komandanti i Shtabit të Pergjithshëm e Përfaqësuesi Politik i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, Kryetari i BDI-së, është i pari dhe deri tash i vetmi shqiptar jashtë kufinjve politik të Kosovës, të shqiptarëve

në ish-jugosllavi, që ftohet në Tribunalin Ndërkombëtar për Kosovën në Hagë!

Ftesa e Hagës për Ali Ahmetin është edhe një dëshmi më shumë se sa thellë e në çfarë përmase ishte i përfshirë për fillimin e luftës, për oranzimin e saj, për zhvillimin me sukses të saj, për rritjen dhe fuqizimin e UÇK-së, për çlirimin e Kosovës dhe Pavaresinë e saj nga Serbia pushtuese!

Ftesa në Hagë për Ali Ahmetin është edhe një argument me shumë, se sa shumë e pazgjidhshëm është i lidhur me Kosovën e tij të dashur e të shtrenjtë, Lideri karizmatik shqiptar nga Zajazi Legjendarë i Maqedonisë së Veriut!

Populli shqiptar në Maqedoninë e Veriut me ftesën që i ka ardhur Udhëheqësit të tij të dashur, të nderuar e të


shtrenjtë, duhet të ndjehet i knaqr dhe i lumtur, sepse edhe kështu në këtë formë aspak të dëshiruar nga çdo pjestar shqiptar, por po dëshmohet se kontributi i bijëve të tij që kanë lindur në truallin e lashtë të të parëve tanë në luftën për çlirimin e Kosovës, është i madh dhe kolosal!

Thirja ne procesin e Hagës te personalitetit emblematik te çështjes kombëtare Ali Ahmeti, është edhe nje gurë prove për luftëtarin e madh kombëtar!

Tribunalit te Hagës, përfshirja në procesin e saj kundër luftëtarëve, komandantëve e themeluesve të UÇK-së në pergjithësi dhe kjo e Ali Ahmetit në veçanti, i jep dimension edhe më të madh dhe shpresë se njëllosja e luftës legjendarë të UÇK-së do të dështojë me turp!

Prishtinë, 23 Korrik 2020!





# ALI AHMETI DO TË MBROJË UÇK NE HAGE



**Ismet SYLEJMANI**

Ali Ahmeti personalisht ka njoftuar se ka marrë ftesë nga Tribunali Ndërkombëtar dhe do të shkojë në Hagë!

Ali Ahmeti në Hagë do të shkojë dhe atje do të takojë shokët, bashkeveprimtarët dhe bashkëluftëtarët e Tij të LPK-së e të UÇK-së!

Në Tribunalin Ndërkombëtar në Hagë janë ftuar disa nga udhëheqësit e lartë të LPK-së dhe shumica e themeluesve të UÇK-së! Ali Ahmeti me dëshminë e Tij në Hagë, historia do të dëshmojë se do mbrojë UÇK-në, jo pse është njëra prej krijesave për të cilën ka hedhur firmë dhe i takon ta

mbrojë, por edhe se është biri më i madh dhe udhëheqësi më i lavdishëm i popullit shqiptar jashtë e brenda Shqipërisë! Është bërë jo vetëm ngjarje dite, por do të jetë ngjarje jave e muaji, ftesa nga Haga dhe dhe përgjigjja pozitive e pa hezitim e dalë-zotësisht të fateve të popullit dhe Atdheut!

Nuk është rastësi që Gjykata Speciale në Hagë, thërret për të dëshmuar udhëheqësin e shquar dhe veprimtarin e palodhshëm të LPK-së, njërin prej themeluesve të parë të Sektorit të veçantë e më vonë të UÇK-së, por edhe Anëtarin e parë të Shtabit Qëndror të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ali Ahmetin e thjeshtë e të madh, dhe të pamposhtur si vargmalet e Alpeve shqiptare!

Te Ali Ahmeti, te ky pjestar me fuqi të pashembullt shpirtërore, qëndron fuqia e madhe e anteut të papërkulur të Atdheut, sepse me vite të tëra u vu dhe qëndroi stoikisht në ballë të luftës për liri

të popullit shqiptar në ish-jugosllavi!

Në udhëheqje të shqiptarizëm ky burrë i urtë e largëpamës, dirigjon me shkathësi e profesionalizëm politik në shërbim të Atdheut!

Ali Ahmeti është politikani patriot e veprimtari politik kombëtar, që në Hagë shkon me vlerësim maksimal ndërkombëtar në respektim të shtetit ligjorë dhe funksionimin euroatlantik të agjendës së Tij për Maqedoninë e Veriut, për popullin dhe për Atdheun e Kombin shqiptar!

Ali Ahmeti, në Tribunalin e Hagës do të shkojë jo vetëm të mbrojë UÇK-në, por do të mbrojë edhe Kosovën e Pavaruar e Sovrane në kufijtë e saj të njohur e të pranuar ndërkombëtarisht!

Të gjithë jemi të bindur se Ali Ahmeti, pasi është ndër themeluesit e UÇK-së, UÇPMB-së dhe i UÇK-së në Maqedoni, do të shkëlqejë me madhësi në Tribunalin Ndërkombëtar në Hagë, do ti tregojë gjithë botës se

LPK dhe UÇK ishin mekanizmat politiko-ushtarak, të cilët të ndihmuar edhe nga aletaët tanë të mëdhenj SHBA, BE dhe NATO i dhanë fund robërisë shekullore të Serbisë në Kosovë!

Ali Ahmeti, Komandanti heroik i Shtabit të Përgjithshëm e Përfaqësuesi Politik i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, Lideri shpirtërorë e moral, themeluesi e Kryetari historik i BDI-së, jo vetëm është i pari dhe dhe deri tash i vetmi shqiptar jashtë kufinjve politik të Kosovës e Viseve të saja, të shqiptarëve në ish-jugosllavi, por edhe nuk do të ketë tjetër që do ftohet në Tribunalin Ndërkombëtar për Kosovën në Hagë, sepse më kompetent e më me të përgaditur, më të dëshmuar në luftë kundër Serbisë pushtuese nuk ka pasur në radhët e saja as LPK, e as UÇK as në Kosovë, as UÇK në Maqedoninë e Veriut as UÇPMB në Luginë të Preshevës! Ftesa për në Tribunalin e Hagës për Ali Ahmetin është edhe një argument dhe një dëshmi më e

madhe, se sa shumë e në çfarë përmase ishte i organizuar e organizatorë për fillimin e luftës së armatosur, për drejtimin titanik të saj, për zhvillimin me sukses të operacioneve të para të saj, për kontaktet e para me Komandantin Legjendar, Heroin e Kombit Adem Jashari, për takimet e rregullta me Komandantin syshqiponjë Heroin e Kombit Zahir Pajaziti, për rritjen dhe fuqizimin embrional të UÇK-së, e cila për çlirimin e Kosovës dhe Pavaresinë e saj nga Serbia pushtuese u bë alfa dhe omega!

Ftesa për në Tribunalin e Hagës për Ali Ahmetin, është edhe një argument me tepër, është edhe një fije më shumë, dëshmi se sa shumë dhe e pazgjdhshme është lidhja e Tij me Kosovën për të cilën ishte i gatshëm të shkrihej në çdo çast!

Tribunali i Hagës, do ta shkruajë me shkronja të mëdha në historinë e Tij emrin e Ali Ahmetit!

**Prishtinë, 23 Korrik 2020!**

# Hapësirat shqiptare: Qeverisje pa moral, politika të dështuara, liderë që nuk dorëhiqen



**Prof. Lisen BASHKURTI**

Bota shqiptare në hapësirat e veta në Ballkan po përballet me sfidat e tranzicionit të gjatë. Në Shqipëri drejt konsolidimit të demokracisë. Në Kosovë drejt shtetformimit. Në Maqedoninë e Veriut drejt integritit të gjithanshëm në shtetin ku jetojnë. Në Mal të Zi dhe Luginën e Preshevës drejt afirmimit të identitetit etno-kulturor dhe social-ekonomik. Në të gjithë rastet është politika shqiptare që ka ndikuar dhe po ndikon në ecurinë e këtyre proceseve.

Etërit e politikës dhe të shkencave politike, Aristoteli, Platoni, Sokrati, Laswell e të tjerë, deri në kohët tona e definojnë politikën si “tërësi veprimtarish që lidhen me vendimmarrjen në grup, ose si forma të tjera të pushtetit ndërmjet individëve për ndarjen e burimeve dhe statuseve”; si “marrëveshje midis popullit, që të mund të jetojnë së bashku në grupe të caktuara, duke pasur një formë qeverisje”; ose “si diçka që lidhet me qytetin dhe qytetarët”; ose e definojnë politikën “si vendime qeverie me theks lidhjen midis qëllimeve politike dhe mënyrave politike të përdorura për realizimin e tyre”; ose e lidhin politikën me “idetë më të fuqishme të të drejtave e njeriut në kohën tonë”.

Rrjedhur nga këto përcaktime mbi politikën definohet edhe politikani, si një person aktiv në grupe, organizata apo parti politike që mban ose kërkon të mbajë një pozicion në qeveri. Qëllimet e politikanit lidhen me mbështetjen dhe krijimin e ligjeve ose politikave që qeverisin një territor dhe që shtrihen mbi popullin që ka lindur dhe zhvillon identitetin dhe statusin e tij etno-kulturor dhe social-ekonomik në atë territor dhe nën ato ligje dhe politika.

Pavarësisht prej hapësirave, statuseve dhe niveleve të zhvillimit e gjithë hapësira

shqiptare në Ballkan po përballet me disa sfida të përbashkëta. Këto sfida kanë të bëjnë me nevojën e kapërcimit cilësor të politikës dhe politikanëve shqiptarë, kapërcim i cili po vonohet dhe pengohet nga vetë politika dhe politikanët që po zënë myk ndër tempujt e pushtetit, të ndotur nga humbja e moralit, të ndryshkur nga pengimi i rotacioneve demokratike, të inkriminuar e korrumpuar nga kultura e mosndëshkimit nga drejtësia. E, megjithatë, tri institucioneve të pastrimit të politikës dhe politikanëve, moralit, rotacionit dhe drejtësisë, nuk i shpëton dot as hapësira shqiptare në Ballkan. Institucioni i moralit është nga më themeloret për politikën dhe politikanët. Morali si kategori universale ndan të mirën nga e keqja, të dobishmen nga e dëmshmjia, të ndershmen nga e pandershmjia, legjitimen nga jolegjitimja, të ligjshmen nga e kundërligjshmjia, shoqëroren nga egoistja. Morali është tejet i lidhur me politikën dhe politikanët. Çdo moral ka politikën e vet, por asnjë politikë nuk mund të mbijetojë pa moral. Kur politika ose politikanët humbasin moralin atëherë politika dhe politikani kanë humbur të drejtën, të dobishme dhe legjitimitetin të ekzistojnë.

Morali është institucion më vete. Morali përgjithësisht dhe në politikë veçanërisht lidhet me marrëdhëniet njerëzore, me vlerat njerëzore, me dobishmërinë njerëzore, me drejtësinë njerëzore. Rënia e moralit do të thotë ndërprerja e lidhjes së politikës me njerëzit, do të thotë cenimi ose shkelja e vlerave njerëzore, do të thotë humbja e dobishmërisë shoqërore, do të thotë mungesa e drejtësisë shoqërore.

Institucioni i moralit në politikë është gjykim njerëzor, opinional, sa përceptimor aq dhe real i qytetarëve mbi politikën dhe politikanët. Për sa kohë institucioni i moralit buron nga vlerësimi, gjykimi, opinionimi dhe perceptimi i shoqërisë për politikën dhe politikanët, ky institucion është dhe duhet të jetë vetëreflektues, vetëreagues, vetëkorrigjues ose vetëdorëheqës.

Politika dhe politikanët aktualë në botën shqiptare përgjithësisht nuk e njohin dhe as nuk e respektojnë institucionin e moralit. Është kjo arsyeja që politika dhe politikanët e botës shqiptare në Ballkan nuk vetëreflektojnë ndaj rënies së moralit, nuk vetëreagojnë ndaj vlerësimeve, gjykimeve dhe opinionëve të qytetarëve, nuk vetëkorrigjohen nga mendimi kritik politik, opinional, mediatik apo ndërkombëtar dhe thujtase nuk e njohin vetëdorëheqjen për shkaqe morale.

Në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut, politika dhe politikanët kanë rrëshqitur prej kohe nga tërësia e parimeve, standardeve dhe parimeve morale që rrjedhin nga kodi i politikëbërjes, vendimmarrjes dhe implementimit që kanë baza në një filozofi të caktuar, në një besim fetar, në një kulturë ose në standarde universalisht të njohura dhe të respektuara rreth koncepteve të së “mirës” dhe të së “drejtës”.

Qeveritë, politika dhe politikanët shqiptarë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, kanë mungesë të theksuar etike politike, e njohur si moralitet politik ose etikë publike. Qeverive, politikës shqiptare dhe politikanëve shqiptarë të këtyre vendeve u mungon dukshëm praktika e bërjes së gjykimit moral rreth mendimeve, qëndrimeve dhe veprimeve politike të aktorëve politikë.

Qeverive dhe politikanëve shqiptarë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut u mungon dukshëm moraliteti në dy fusha: së pari, në etikën e proceseve ose të zyrës, që ka të bëjë me zyrtarët publikë dhe, së dyti, me metodat që ato përdorin në punët publike. Politika është çështje etike. Qeveritarët, politikanët shqiptarë aktualë në Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi, në masën më të madhe nuk e konsiderojnë si të tillë.

Në mënyrë të veçantë vitet e fundit në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut janë shtuar gjykimet kritike, opinionet qortuese dhe perceptimet negative për qeveritë dhe liderët që drejtojnë agjencitë ekzekutive në këto

vende. Qeveritë, qeveritarët dhe politikanët shqiptarë po akuzohen për veprimtari kriminale ose të lidhura me krimin, si vrasje, droga, trafikë të paligjshme, vjedhje, dhunime e përdhunime, gënjeshtër e mashtrime, shkelje premtimesh dhe shantazhimesh mbi kundërshtarët politikë, biznese, administratë publike dhe media. Këto dukuri janë moralisht të ndaluara, janë dukuri që nuk duhen bërë kurrsesi dhe aq më pak nuk duhen përsëritur pambarimisht.

Qeveria Rama në Tiranë dhe drejtuesit kryesorë të saj janë kampionë në rëniën e moralitetit në zyrë, në mënyrën sesi po punojnë zyrtarët e tyre publikë dhe në metodat e drejtimit që po ndjekin në qeverisje. Ndërkohë qeveritë në vitet e fundit në Kosovë dhe liderët e tyre si Hashim Thaçi e Isa Mustafa dhe pasuesit e tyre po udhëheqin dukshëm pa moralitetin e duhur, duke u ndeshur në rritje me mendim kritik qytetar, me opinionet përherë e më qortuese dhe me perceptime gjithnjë e më negative. Përfaqësuesit shqiptarë në Qeverinë e Maqedonisë së Veriut në mënyrë të veçantë, Ali Ahmeti e Menduh Thaçi, po gjykohen gjithnjë e më shumë nga qytetarët për humbje të moralitetit në politikë, përballet me opinionet gjithnjë e më kritike dhe po ballafaqohen me perceptime gjithnjë e më negative.

Disa prej këtyre liderëve si Rama, Thaçi apo Ahmeti kapen pas rezultateve të zgjedhjeve. Por, tanimë dihet e njihet ndërkombëtarisht se tranzicionet e tejzgjatura në Ballkanin Perëndimor po krijojnë demokraci hibride. Në demokracitë hibrite zgjedhjet nuk janë gjithnjë indeksi më real i moralitetit në politikë. Madje, si në rastin e Shqipërisë, aty-këtu edhe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, zgjedhjet janë indeksi më i dukshëm i mungesë së demokracisë

Liderët e lartpërmendur shqiptarë si Rama, Thaçi, Mustafa, Ahmeti dhe shumë kolltukmbajtës së tyre drejtojnë prej dekadash partitë, prej

shumë mandatesh qeverisin, kanë lënë një mal dështimesh, kanë krijuar shumë zhgënjime e dëshpërime në popull, në intelektualë dhe rini. Me këtë krizë morale që kanë prodhuar këta liderë aktualë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, kanë krijuar patologjinë sociale të braktisjes së trojeve shqiptare. Kurrë më parë nuk ka pasur një patologji sociale të braktisjes së trojeve shqiptare si në vitet e fundit. Patologjia sociale e braktisjes së trojeve shqiptare është akuza më e rëndë morale mbi këta liderë politikë. Por, megjithatë, asnjë nga liderët e lartpërmendur nuk e ka parë të arsyeshme të vetëkorrigjohet dhe aq më pak të vetëdorëhiqet nga politika.

Të gjithë liderët e lartpërmendur kanë zënë myk ndër zyra. Ata janë të gatshëm të qeverisin këto troje edhe pa popull. Ata po injorojnë përbaljen me një krizë të thellë morale. Ata po e hanë turpin me bukë. Kjo krizë e krijuar prej tyre sa më shumë të zgjasë aq më shumë do të jetë varmihëse për vetë ato si dhe do ta shtojë agoninë e hapësirave shqiptare në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut e gjetkë. Pavarësisht prej hapësirave, statuseve dhe niveleve të zhvillimit, e gjithë hapësira shqiptare në Ballkan po përballet me disa sfida të përbashkëta. Hapësira politike shqiptare në Ballkan ka nevojë kapërcimit cilësor, kapërcim të cilin po vonojnë dhe pengojnë vetë qeveritë, politika dhe politikanët që po zënë myk ndër tempujt e pushtetit, të ndotur përherë e më shumë nga humbja e moralit, të kalbur nga pengimi i rotacioneve demokratike, të inkriminuar e korrumpuar deri në fyt nga kultura e mosndëshkimit nga drejtësia. E, megjithatë, tri institucioneve të pastrimit të qeverisjeve, politikës dhe politikanëve siç janë morali, rotacioni politik dhe ndëshkimi i drejtësisë nuk i shpëton dot as hapësira shqiptare në Ballkan. Deri tani institucioni moral nuk po funksionon te këta liderë. Prandaj, mesa duket, po hyjnë në punë dy institucionet e tjera: rotacioni politik dhe ndëshkimi para drejtësisë.

## Miley Cyrus shpenzon mbi katër milionë dollarë me një vilë në Los Anxhelos



**H**iden Hill është bërë vendi i preferuar i 'VIP'-ve. Ajo është bërë anëtarja më e fundit e klikës ekskluzive që jeton prapa portave të mbrojtura të Hidden Hills, në veri të Los Anxhelosit. Miley Cyrus ka shpenzuar 4.95 milionë dollarë për një shtëpi gjashtë dhoma gjumi në një çerek hektar në

enklavën luksoze, raportoi "Variety" të enjten. Shkrimi thoshte se ylli i muzikës pop dhe aktorja, e cila është 27 vjeçe, e kishte mbyllur marrëveshjen jashtë tregut. Rezidenca prej 6 800 metrash katrorë përshkruhet si një tradicion i Bregut Lindor i ndërtuar në vitet 1950, e që kohët e fundit ishte rinovuar krejtësisht.

## Meldina publikon videoklipin 'Nashta'



**M**elinda Ademi ka bërë me dije që ka finalizuar këngën e re. Së fundi, këngëtarja ka postuar disa fotografi të shkëputura pikërisht nga videoklipi i kësaj kënge, në të cilën erdhi joshëse e veshur në të

zeza. Përmes atyre fotografive, Melinda njoftoi fansat se kënga e saj e re bashkë me videoklip me titull 'Nashta' është publikuar të premten. Mbetet të shihet se çfarë ka përgatitur kësaj radhe Melinda Ademi për fansat.



## Ava Max nominohet sërish në 'MTV Music Awards'

**A**va Max është shqiptarja e parë që është nominuar sivjet në 'MTV Music Awards'. Në qytetin e Nju-Jorkut muajin që vjen do të mbahet ceremonia e ndarjes së çmimeve në 'MTV Music Awards' dhe edhe këtë vit, një artiste nga Shqipëria është në mesin e të nominuarve. Bëhet fjalë

për këngëtarjen e disa hiteve Ava Max, e cila është përzgjedhur si kandidat për çmimin "Artistin depërtues të vitit". Ndonëse ende nuk është shpallur lista e të gjithë të nominuarve, ku pritet që edhe Dua Lipa të zë vend, momentalisht Max është këngëtarja e parë shqiptare e nominuar.

## Kanye West refuzon ta takojë bashkëshorten Kim Kardashian



**R**aportohet se reperi po refuzon të takohet me yllin televiziv. Krijuesi i hitit 'All Day', 43-vjeçar, ka ngjallur shqetësim ditët e fundit me një seri postimesh të çrregullta në mediat sociale dhe një paraqitje të çuditshme në një miting për fushatën e tij presidenciale në Karolinën e Jugut - gjatë së cilës ai

qau në mënyrë hysterike, shkruan "Daily Mail". Pas pretendimit të tij tronditës se çifti kishte planifikuar ta abortonte fëmijën e tyre të parë dhe e kritikoi aktivisten Harriet Tubman tani është pretenduar se ai ka pasur shumë pak komunikim me yllin Keeping 'Up With the Kardashians', 39-vjeçar, këtë javë.

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN  
 SEKURIT  
 Pilkimytin  
 Zhveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

# Sermaxhaj: Java e fundit në Superligë do të jetë shumë interesante

Genc Sermaxhaj ka thënë për "Epokën e re" se xhiroja e fundit e kampionatit elit të futbollit do të jetë shumë interesante, pasi disa skuadra luftojnë për daljen në garat evropiane e disa të tjera kërkojnë mbijetesën. Ai ka hezituar të japë ndonjë parashikim, por është i bindur se ndeshje të zjarra do të zhvillohen të dielën

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 KORRIK - Kampionati futbollistik në Kosovë për edicionin 2019/2020 përfundon të dielën. Titulli i kampionit është vendosur në xhiron e parafundit, ku Drita është shpallur për herë të tretë në histori të saj kampione e Kosovës, derisa xhiroja e fundit do të jetë interesante pasi tri skuadra janë në garë për vendin e dytë që dërgon në Ligën e Evropës dhe tri skuadra të tjera janë në garë për mbijetesë. Ish-futbollisti dhe njohësi i mirë i futbollit, Genc Sermaxhaj, ka thënë të premten për "Epokën e re" se xhiroja e fundit do të jetë shumë interesante. Ai ka parashikuar se do të jetë një xhiro interesante dhe se Gjilani dhe Ballkani do të përpiqen të sigurojnë fitore me çdo kusht. "Ballkani dhe Gjilani duhet të bëjnë çmos që njëra ta fitojë ndeshjen për t'u kualifikuar në garat evropiane. Nëse mbesin bars të dy ekipet atëherë, Gjilani kalon si e dyta

në Evropë. Ballkanit i duhet vetëm fitorja ndaj Dritës, por edhe Gjilani nëse fiton atëherë renditja mbetet po e njëjta dhe nuk do të ketë ndonjë ndryshim në renditje. Do të jenë ndeshje si finale ngaqë sigurojnë Evropën dhe angazhimi maksimal nuk do të mungojë", ka thënë Sermaxhaj. Ish-mesfushori i njohur foli edhe për skuadrat që janë në garë për ta siguruar mbijetesën në IPKO Superligë. Sermaxhaj ka thënë se është e vështirë të parashikohet se cila skuadër do të bjerë nga elita, por xhiroja e fundit do të jetë shumë interesante. "Sa i përket rënies nga Superliga janë të rrezikuara tri skuadra: Flamurtari, Drenica dhe Trepça '89. Një prej këtyre tri skuadrave do t'i bashkohet Ferizajt, Dukagjinit dhe Vushtrrisë në Ligën e Parë. Është vështirë të parashikohet se cila skuadër do të bjerë, por do të jetë javë vendimtare dhe shumë interesante", ka deklaruar Sermaxhaj. Të gjitha ndeshjet e javë së fundit zhvillohen të dielën nga ora 17:00.

## IPKO Superliga - Xhiro e fundit

Të dielën takohen:  
 Drenica - Dukagjini  
 Vushtrria - Llapi  
 Ferizaj - Ferizaj  
 Trepça '89 - Prishtina  
 Flamurtari - Gjilani  
 Ballkani - Drita

	Tabela	Pikë
1. Drita	32	68
2. Gjilani	32	65
3. Ballkani	32	64
4. Prishtina	32	62
5. Llapi	32	45
6. Feronikeli	32	44
7. Flamurtari	32	43
8. Trepça '89	32	41
9. Drenica	32	41
10. Ferizaj	32	29
11. Dukagjini	32	19
12. Vushtrria	32	18

## SHKURT

### Më 29 korrik zhvillohet finalja e Digitalb Kupës

Finalja e Digitalb Kupës së Kosovës në futboll në mes të Prishtinës dhe Ballkanit do të zhvillohet më 29 korrik në stadiumin "Fadil Vokrri" me fillim nga ora 17:45. Ndeshja që është përcaktuese për skuadrën që do ta dalë në garat evropiane do të luhet pa shikuese për shkak të masave mbrojtëse ndaj Covid-19.

### Feronikeli kërkon tre yjet e Prishtinës

Klubi i Feronikelit ka nisur të mendojë për edicionin e ri të Superligës. Tri herë kampioni i Kosovës ka nisur bisedimet për t'i angazhuar lojtarët më në formë të futbollit në Kosovë. "Olle" mëson ekskluzivisht se drejtuesit e Feronikelit janë parë në takim me tre lojtarët e Prishtinës, kapitenin Armend Thaqi, sulmuesin Ahmed Januzi dhe mbrojtësin Ahmet Haliti.

### Tirana transferon Avdijajn

Kampionia e Shqipërisë në futboll, Tirana, ka zyrtarizuar të enjten transferimin e parë për edicionin e ri të garave. Sulmuesi kosovar, Albion Avdijaj ka nënshkruar kontratë dy-vjeçare. Marrveshja u arrit pas negociatave nga menaxheret e kompanisë (AK Sports Consulting & Partners). 26-vjeçari ka luajtur grupmoshat e reja të Zvicrës. Kurse dy ndeshje luajti edhe për Kosovën U-21. Gjithashtu ka luajtur për Grasshopperin, Vaduzin, Wolfsburgun II, Debrecenin dhe Viborgun.

### Drita mëson kundërshtarit në Ligën e Kampionëve

Drita ka mësuar zyrtarisht emrin e kundërshtarit në gjysmëfinalen e raundit paraeliminatory të Ligës së Kampionëve për sezonin 2020-2021. Skuadra e Ardian Nuhit, të cilën shorti i hedhur pak ditë më parë e kishte vendosur përballë kampiones së Andorrës, do të përballlet në gjysmëfinale me ekipin e Inter Escaldes që mbrëmjen e të mërkurës fitoi për herë të parë në historinë e saj titullin kampion në Andorra. Bëhet fjalë për një skuadër që është krijuar 29 vjet më parë dhe luan për herë të parë në kompeticionet evropiane. Sfida mes këtyre dy skuadrave do të zhvillohet në javën e dytë të gushtit në Nyon me Dritën që është e favorizuar për të kaluar në finalen e turit paraeliminatory aty ku do të përballlet me fituesen e çiftit Linfield-Tre Fiori.


## Joshua: Nuk e kuptoj përse njerëzit e konsiderojnë Furyn të rrezikshëm

LONDËR, 24 KORRIK - Boksieri britanik Anthony Joshua, kampion bote në peshën e rëndë, ka deklaruar se patrioti i tij Tyson Fury nuk ka shumë kohë që noton në ujëra kaq të thella, që është prej vitesh kampion bote, sa të konsiderohet frikësues në ring. "Nuk e kuptoj se përse

njerëzit e pëlqejnë Tyson Fury, se çfarë shohin të mirë tek ai. Sepse di të bëjë mirë finte në ring? Di të lëvizë? Çfarë shohin tek ai që e bëjnë frikësues? Mos ka shpejtësi?", u shpreh Anthony Joshua. "Unë punoj fort, jam i motivuar dhe studio fort për të arritur në majë. Nuk men-

doj se gjeneratat e sotme shohim shumë talent te një boksier që bën shumë finte në ring", tha më tej Joshua. "Sigurisht se unë e konsideroj atë si një sfidant serioz, por atij i është dashur shumë kohë që të rritet si njeri. Ka dueluar me Wladimir Klitschko, sfida e tij e parë e

rëndësishme dhe arriti të triumfojë. Më pas, ka dueluar dy herë me Deontay Wilder. Gjithsesi, ai ka nevojë që të provojë se arrin të notojë gjatë në këto ujëra, nuk mjafton vetëm një apo dy herë. Vetëm kështu ai mund të tojë respektin tim si boksier", ka deklaruar Joshua.



## Juniku: Sfidë e madhe për Kosovën

PRISHTINË, 24 KORRIK - Kosova A te femrat për herë të parë do të paraqitet në garat ndërkombëtare vitin e ardhshëm. Bordi i FBK-së ka vendosur që të formohet Përfaqësuesja A te femrat dhe të luajë në arenën ndërkombëtare. Kjo ide është pëlqyer nga komuniteti i basketbollit në Kosovë.

Resmije Juniku, ish-basketbolliste e Gjeneratës së Artë e Universitetit të Prishtinës, në fund të viteve '70 dhe në vitet '80 ka folur për këtë ide. "Do të jetë një sfidë e madhe për Kosovën. Duhet shumë punë. Sigurisht se është një motivim për gjeneratat e reja. Gjithashtu, edhe për disa lojtare me përvojë, të luajnë dhe ta përfaqësojnë vendin në arenën ndërkombëtare. Përvoja është një faktor i rëndësishëm, megjithatë ajo fitohet duke luajtur, sidomos në garat evropiane. Fillimi nuk do të jetë i lehtë, por me punë mund të arrihen sukseset", është shprehur Juniku për faqen zyrtare të FBK-së.



Kosova A (femrat) pritet të marrë pjesë në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla, që do të organizohet në vitin e ardhshëm në Nicosia të Qipros prej 15 deri më 20 qershor. Në FIBA Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla-Femrat në vitin 2020 janë paraqitur për të garuar: Andorra, Qipro, Gjibraltari, Irlanda, Luksemburgu, Malta dhe Norvegjia, por që u anulua për

shkak të pandemisë Covid-19. Regjistrimi i shteteve për pjesëmarrje në FIBA Kampionate Evropiane në FIBA Europe do të bëhet si zakonisht, pra ndërmjet muajve shtator/tetor 2020. FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha Federatat Nacionale që t'i regjistrojnë ekipet e tyre për vitin 2021, pasi regjistrimet e paraqitura për vitin 2020 nuk do të merren parasysh.

## Mavraj kërkon lirinë e Palestinës, klubi i tij distancohet pas debatit kontrovers

FURTH, 24 KORRIK - Mërgim Mavraj kthehet përsëri në qendër të vëmendjes dhe përsëri për ngjarje që kanë të bëjnë pak me fushën e futbollit. Këtë herë, ish-kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë akuzohet për qëndrim anti-Semit pasi ka fshirë nga harta Izraelin në një postim. "Nürnberg Zeitung" shpjegoi se pak ditë më parë Mavraj kishte postuar një foto në "Instagram", në të cilin silueta e territoreve të Izraelit dhe Palestinës ishin mbuluar me lule. Në mes të fotos, me hashtag #FreePalestine (lironi Palestinën), shiheshin edhe konturet e Jerusalemit, por poshtë shkruhej vetëm Palestinë. Ndërsa Izraeli nuk paraqitej si shtet në hartë. Një reagim i cili sipas Daniela Einshtajn, drejtoresha e Muzeut Hebraik në Franken, tregonte se Mavraj mbante qëndrim anti-Semit më këtë postim. "Kjo sjellje është e papranueshme, mesazhi i Mavraj kundërshton të drejtën e Izraelit për të ekzistuar", theksoi ajo. Klubi i Greuther Furthit, pjesë e



të cilit është Mavraj, u distanca nga publikimi i mbrojtësit. "Si një klub, ne jemi pro tolerancës, diversitetit dhe barazisë dhe jemi kundër diskriminimit, racizmit dhe përjashtimit, të cilën ne e shprehim rreth fushatave tona vazhdimisht. Ndaj distancohemi nga publikime të tilla", shkruante klubi në reagimin e tij. Por ky lajm ka acaruar dukshëm Mavrajn, i cili nuk pranon akuzat dhe mendon se po e tepronjë me një përshkrim të tillë. "Përfundimi se unë jam anti-

Semit është primitiv në kohët tona. Izraeli dhe Palestina kanë të njëjtën të drejtë të jenë në hartën e botës. Unë nuk i mohova Izraelit të drejtën për të ekzistuar", shpjegoi ai për mediat gjermane. Ndërkohë, gjatë pasdites Mavraj ka postuar disa video në "Instagram" ku shpjegonte se nuk kishte qëndrim anti-Semite, por thjesht kërkonte që edhe Palestina t'i kishte të njëjtat të drejta. "Demokracia është për të dyja palët", shkruante Mavraj.

### SHKURT

#### Henderson shpallet futbollisti i vitit në Premierë Ligë

Jordan Henderson është zgjedhur futbollisti më i mirë i sezonit 2019-2020 në Premierë Ligë nga Shoqata e Gazetarëve të Futbollit Britanik. Kapiteni i Liverpoolit është vlerësuar me këtë çmim special për vetë faktin se ishte një nga lojtarët më të mirë dhe lideri i "The Reds" në këtë edicion historik që riktheu titullin në "Anfield Road" pas 30 vjetësh. Henderson, i cili është aktivizuar në 30 takime me Liverpoolin në këtë sezon, mposhti në përzgjedhjet e gazetarëve dhe korrespondentëve sportivë konkurrencën e yllit të Manchester Cityt, Kevin De Bruyne dhe atë të sulmuesit të Manchester Unitedit, Marcus Rashford.

#### Kane do të largohet nga Chelsea

Chelsea është e gatshme t'i vlerësojë ofertat për shitjen e N'Golo Kante, raportojnë mediat angleze. Fituesi i kampionatit botëror me Francën nuk konsiderohet më futbollist kyç në "Stamford Bridge" nga menaxheri Frank Lampard. Kante spekulohet se do të gjejë një ekip të ri gjatë afatit kalimtar të verës, kurse për mesfushorin interesim ka shfaqur Interi.

#### Pioli: Pas 2 gushtit vendoset e ardhmja e Ibrahimoviçit

